

Raporti i vecantë

**“Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit
për ushqim, për fëmijët”**

PËRMBAJTJA

Hyrje

Qëllimi

Metodologjia

- 1. Kuadri ligjor lidhur me detyrimin ushqimor për fëmijët*
- 2. Garancite Juridiksionale*
- 3. Analiza të rasteve konkrete realizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit*
- 4. Përfundime dhe rekomandime**
- 5. Bibliografia*

LISTA E SHKURTESAVE

RSH – Republika e Shqipërisë

KF – Kodi i Familjes

KPrC – Kodi i Procedurës Civile

LDMF – Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

KDF – Konventa për të Drejtat e Fëmijës

KLZD – Konventa mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore

KNJZVDU – Konventa mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve ne Lidhje me Detyrimet Ushqimore

GJEDNJ – Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut

AP – Avokati i Popullit

KMPDF – Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

SMPDF – Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

MD – Ministria e Drejtësisë

ZPSH – Zyra e Shërbimit Përmbartimor Shtetëror

MSHMS – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

NJMF – Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

STHC – Save the Children

Përmbledhje Ekzekutive

Nga analiza e legjislacionit shqiptar rezulton, se detyrimi ushqimor është një ndër detyrimet kryesore të çdo prindi ndaj fëmijës së tij. Detyrimi për ushqim i prindërve ndaj fëmijëve të tyre ekziston jo vetëm gjatë martesës, por i shtrin efektet ligjore edhe pas zgjidhjes së martesës. Por më tepër ai është një detyrim edhe për fëmijët e lindur në bashkëjetesën e çiftit apo jashtë martese.

Zgjidhja e martesës realizohet me vendim të gjykatës, prandaj është një akt juridiko–ligjor që ndërpret lidhjet e krijuara nga martesa mes bashkëshortëve. Gjithashtu është edhe një proces juridiko–civil, pasi përfshin çështje të ndryshme që lidhen me pasurinë, kujdestarinë e fëmijëve, përkrahjen social–emotive të fëmijëve apo të të afërmeve të tjerë. Për fëmijët zgjidhja e martesës nuk është një ngjarje kalimtare, por është një proces që zgjat për shumë vite dhe impakti i tij në sjelljen e fëmijëve ka ngjallur një interes të veçantë për shumë studiues.

Avokati i Popullit konstaton, se në legjislacionin tonë nuk është përcaktuar një shumë konkrete (fikse), për të treguar se sa do të jetë detyrimi për ushqim i prindit në plotësim të nevojave të fëmijës së tij, por është lënë në vlerësimin e gjykatës. Në caktimin e pagesave të masës së detyrimit ushqimor për fëmijët nga prindërit e tyre, gjykata është e detyruar të marrë në konsideratë dy faktorë të rëndësishëm:

- Faktori i parë lidhet me vlerësimin e nevojave materiale dhe kulturore për rritjen, arsimimin dhe edukimin e fëmijëve. Në fokus është mosndryshimi dhe ruajtja e standarteve dhe cilësisë së jetesës që fëmijët kanë patur para zgjidhjes së martesës të prindërve të tyre.
- Faktori i dytë lidhet me mundësitë financiare dhe gjendjen ekonomike të prindit që është i detyruar të përmbushë detyrimin për ushqim.

Detyrimi i prindërve të ushqejnë fëmijët e tyre shtrihet në radhë të parë mbi fëmijët e mitur që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar, pavarësisht nga aftësia e tyre për punë. Megjithatë, sipas dispozitave të KF, detyrimi ushqimor i prindërve vazhdon edhe ndaj fëmijëve madhorë që ndjekin shkollat e mesme ose të larta me shkëputje nga puna deri në 25 vjeç. Pra, detyrimet financiare të prindërve që nuk kanë paguar pensionin ushqimor ndaj fëmijëve, janë të kërkueshme derisa fëmija të mbushë moshën 18 vjeç dhe, në rast të kryerjes së studimeve universitare deri në përfundimin e tyre. Ky përcaktim ligjor i vendos prindërit që nuk paguajnë detyrimin ushqimor në cilësinë e debitorit.

Me vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet edhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën. Zbatimi i detyrimit për ushqim nuk është fakultativ, pasi përcaktohet në një vendim gjyqësor dhe për rrjedhojë, është i detyrueshëm për t'u zbatuar. Moszbatimi sjell edhe përgjegjësi penale për prindin që nuk ka kryer pagesën e detyrimit ushqimor. Ndërkohë duhet kuptuar qartë, se detyrimi i vendosur gjyqësisht është detyrim minimal i prindit ndaj fëmijës, ndaj ky vendim mund të ndryshojë ose ri-shikohet sipas kërkesave dhe nevojave të fëmijës.

Legjislacioni i brendshëm përcakton, që prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi i tyre për të ushqyer fëmijët e tyre, edhe sikur t'u hiqet e drejta prindërore.

Analizimi i rasteve me iniciativë apo ankesave të cilat janë shqyrtuar nga Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e AP, ilustron më së miri nevojën për të adresuar drejt këtë problematikë, si dhe nevojën për të patur një metodologji si udhëzues për gjyqtarët, në dhënien e vendimeve të tilla në praktikën gjyqësore. Nga ana tjetër, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesa më kryesore dhe më e rëndësishme e realizimit të së drejtës në një shtet ligjor. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre¹.

Procedurat për marrjen e shërbimeve përmbartimore janë me afate të gjata kohore dhe ka raste jo efçente për sa i përket realizimit të së drejtës. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj². Ndërkohë afati i kërkimit të detyrimit për ushqim është i shkurtër, 6 (gjashtë) muaj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ndër vite, ka pasqyruar në raportet vjetore lidhur me gjendjen e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve. Megjithatë, situata nuk rezulton të jetë përmirësuar. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, me objekt detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve, praktikisht e bën mjetin ankimor gjyqësor të paefektshëm dhe gjithashtu passjell pasoja negative edhe në cilësinë e standartin e jetesës të fëmijëve.

¹shih vendimin nr.79, datë 27.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese

² shih vendimin nr. 75, datë 23.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese

Çdo fëmijë ka të drejtë të gëzojë të drejtat në përputhje me standardet e Konventës e KB për të Drejtat e Fëmijës në interesin më të lartë të tyre. Një ndër të drejtat e fëmijës është dhe e drejta për pjesëmarrje në vendimmarrje. Garantimi i kësaj të drejte fokusohet në ekzistencën e proceseve efektive ku zëri i fëmijëve dëgjohej, vlerësohet dhe respektohet në vendimmarrje që lidhen me të drejtat e tyre, ku përfshihen dhe proceset gjyqësore. Termi “drejtësi miqësore për fëmijet” u parashikua për herë të parë në udhëzimet e Këshillit të Evropës, Drejtësia Miqësore për Fëmijët, publikuar në vitin 2010. Ky dokument është një përmbledhje e parimeve ndërkombëtare, udhëzimeve dhe praktikave që synojnë të përshtatin procesin ligjor me nevojat dhe të drejtat e fëmijëve³. Legjislacioni i brendshëm i harmonizoi këto dispozita në ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018. Ky legjislacion forcon konsiderueshëm sistemin e drejtësisë për të mitur dhe është në bashkërendim me KDF-në, me standardet dhe normat e tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve duke garantuar respektimin dhe zbatimin efektiv të të gjitha të drejtave të fëmijëve në interesin e tyre më të lartë.

Në këtë kuptim, sistemi i drejtësisë duhet të jetë i aksesueshëm, i përshtatshëm për moshën dhe nevojat e fëmijës, me procedura të shpejta, të fokusuara në nevojat dhe të drejtat e fëmijës, duke respektuar këto të drejta në kuadër të procesit të rregullt ligjor, që fëmijët pjesëmarrës të kuptojnë procedurat ligjore, t’iu respektohet jeta private dhe familjare dhe të mundësohet integrimi i tyre në shoqëri.

Pavarësisht, punës së mirë të kryer në hartimin e kuadrit ligjor me qasjen e drejtësisë miqësore për të miturit, AP thekson, se pjesëmarrja e fëmijëve në aspektet proceduriale duhet të ketë mjedise dhe metoda pune që duhet të jenë të përshtatshme në përputhje me kapacitetet e fëmijëve. Gjithashtu, duhet shumë punë për t’u bërë lidhur me fuqizimin e burimeve njerëzore dhe buxhetore për të siguruar që fëmijët të kenë besim dhe mundësi që të kontribuojnë me pikëpamjet e tyre. Trajnimet në vazhdimësi janë të nevojshme për profesionistët e përfshirë në mënyrë që ata të mund të mbështesin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në mënyrë efektive. Ky është element thelbësor që interesat e fëmijëve të jenë një konsideratë parësore në çdo vendimmarrje në gjykatë ose mekanizma të tjerë të drejtësisë duke përfshirë vendimet për caktimin e masës së pensionit ushqimor dhe zbatimin e këtyre vendimeve. Avokati i Popullit thekson se parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të merret parasysh në të gjitha vendimet duke përfshirë vendimet e gjykatave dhe politikat e ndryshme të qeverisë, të cilat duhet të jenë në sinkron për të bërë të mundur garantimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

³ *Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët*, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 17 nëntor 2010.

Statusi familjar dhe gjendja juridike e fëmijës brenda familjes, është një kusht paraprak për ekzistencën e detyrimit ushqimor të prindërve ndaj tij. Instituti i detyrimit për ushqim të prindërve ndaj fëmijëve lind për shkak të lidhjes së gjakut që krijohet me martesë, si dhe jashtë martese, kur fëmijës i është njohur amësia dhe/ose atësia ose për shkak të birësimit⁴.

Lindja e fëmijës, koha e lindjes, gjinia dhe mëmësia, vërtetohen rregullisht si fakte juridike nga personat zyrtarë ose privatë të pranishëm në ngjarje. Sipas legjislacionit shqiptar amësia e fëmijës të lindur nga martesa provohet nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile⁵, ndërsa amësia e fëmijës të lindur jashtë martese mund të realizohet edhe me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor⁶. Lidhur me njohjen e atësisë së fëmijës të lindur nga martesa kjo provohet nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, ndërsa atësia e fëmijës të lindur jashtë martese mund të realizohet me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

Detyrimi për ushqim i prindit ndaj fëmijës është një detyrim ligjor pa kundërshtpërblim dhe me karakter vetjak, në bazë të të cilit i ati dhe/ose nëna detyrohen t'u sigurojnë mjetet e jetesës fëmijëve të tyre. Legjislacioni shqiptar përcakton qartë, se në familje fëmija është në pozita më të dobëta se anëtarët e tjerë, pasi është i paaftë për punë dhe nuk ka mundësi të sigurojë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Prindërit e kanë këtë detyrim edhe kur ata nuk jetojnë bashkë apo janë të divorcuar.

Detyrimi për ushqim, pavarësisht përmbajtjes së tij ekonomike dhe sociale, kualifikohet si një e drejtë vetjake, pasi është në funksion të realizimit të vlerave parësore të individit. Për rëndësinë e këtyre vlerave ai paraqitet si i patjetërsueshëm dhe që nuk mund t'i nënshtrohet kompensimit.

Për shkak të natyrës së veçantë dhe karakterit ngushtësisht vetjak, detyrimi ushqimor synon të plotësojë nevojat jetësore të fëmijës, i cili nuk ka kapacitete dhe aftësi ligjore për të punuar, deri në moshën kur ai bëhet i aftë për punë⁷.

⁴ Në zbatim të neneve 7 dhe 63, të të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003, Kodi i Familjes, i ndryshuar

⁵ Në përputhje me nenin 165, të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003, Kodi i Familjes, i ndryshuar

⁶ Në përputhje me nenin 170, të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003, Kodi i Familjes, i ndryshuar

⁷ Në përputhje me nenin 197, të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003, Kodi i Familjes, i ndryshuar. Sipas këtij neni, detyrimi për ushqim mund të vazhdojë edhe pasi fëmijët janë madhorë deri në moshën 25 vjec.

Gjithashtu, legjislacioni i brendshëm nuk mundëson kompensimin e detyrimit ushqimor nga Shteti dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi, midis prindit që detyrohet dhe Shtetit.

Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.8454/1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, paraqet raportin e veçantë “Për politikën e pensionit ushqimor pas divorcit”, si një përpjekje e vazhdueshme për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së fëmijëve për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror (standartit të jetesës). Nisur nga trajtimi dhe shqyrtimi i rasteve, Avokati i Popullit ka konstatuar shkeljen e kësaj të drejte në disa raste tek fëmijët e prindërve që zgjidhin martesën, lidhur me marrjen e detyrimit ushqimor që duhet të paguajë prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim. Raporti është mbështetur në vlerësimin dhe analizimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, në lidhje me këtë dukuri, si një ndër shkeljet e të drejtave të fëmijës, kryer ndaj kësaj kategorie të veçantë, të pambrojtur, të papërfshirë si kategori në nevojë në vendin tonë. Synimi i tij është pasqyrimi në mënyrë gjithëpërfshirëse i kësaj dukurie, pasojat dhe masat që duhen ndërmarrë për ta parandaluar atë në nivel kombëtar dhe ndërkufitar.

Legjislacioni i familjes paraqet të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore, të cilat garantojnë, mbrojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet në marrëdhëniet familjare. Ndër parimet thelbësore, legjislacioni shqiptar, përmend parimin e interesit parësor më të lartë të fëmijës. Çështja e mbrojtjes të interesit më të lartë të fëmijës është e rëndësishme; së pari është një detyrë e prindërve, sepse në jetën e përditshme prindërit janë aktorët (faktorët) kryesorë në përmbushjen e detyrimeve në raport me fëmijët dhe së dyti, i takon edhe gjithë shoqërisë ku fëmija jeton.

Legjislacioni i familjes parashikon se bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësi, në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, jo vetëm gjatë martesës apo bashkëjetesës, por dhe në rastet e zgjidhjes së saj. Ndërkohë, është e rëndësishme, që prindërit të sigurojnë që zgjidhja e martesës të mos ndikojë në të drejtat dhe detyrimet, që ata kanë ndaj fëmijëve të tyre.

Prindërit duhet të garantojnë që zgjidhja e martesës apo bashkëjetesës, si dhe mosmarrëveshjet që mund të rrjedhin prej saj, të mos ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që ata kanë për fëmijët e tyre. Zgjidhja e martesës apo bashkëjetesës nuk është një ngjarje kalimtare për fëmijët, por është një proces që zgjat për shumë vite,

prandaj prindërit kanë përgjegjësinë, që pavarësisht konflikteve që mund të kenë mes tyre, të angazhohen për të mos patur ndikime negative në jetën ekonomike të fëmijëve.

Respektimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës është detyrim i prindërve në kontekst të ndërtimit të marrëdhënieve familjare të qëndrueshme, por është edhe një detyrë e aktorëve kyç, si pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës.

Mbarimi i martesës shënon fundin e marrëdhënies martesore për bashkëshortët, duke krijuar një marrëdhënie pasmartesore, kufijte dhe modalitetet e së cilës janë përcaktuar në vendimin e gjykatës, me të cilin është zgjidhur martesja. Nëse pas zgjidhjes së martesës, bashkëshortët ndryshojnë status dhe cilësohen “ish–bashkëshortë”, statusi i të qenurit prind në raport me fëmijët e tyre nuk ndryshon. Pra, është e kuptueshme, që përgjegjësia prindërore nuk shuhet me zgjidhjen e martesës. Prindërit vazhdojnë të kenë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve.

Marrëdhënia prindër – fëmijë është një marrëdhënie specifike, e posaçme dhe tepër e nevojshme për zhvillimin normal të fëmijëve. Me zgjidhjen e martesës raporti dhe marrëdhëniet mes prindërve ndryshojnë, por është e rëndësishme që marrëdhënia mes prindërve dhe fëmijëve të mbetet e pandryshuar.

Në vendin tonë shumë raste të zgjidhjes së martesës kanë pasoja të dukshme, jo të mira tek fëmijët. Ish – bashkëshortët, jo gjithmonë arrijnë të kuptojnë, se pavarësisht se nuk jetojnë më bashkë, duhet të vlerësojnë maksimalisht dhe me prioritet marrëdhëniet me fëmijët, pasi vazhdojnë të jenë prindër të fëmijëve të tyre. Arsyeet e ndarjes së një çifti janë të shumta, por të pakta janë rastet kur ato realizohen me mirëkuptim. Në shumicën e rasteve të zgjidhjes së martesës, si pasojë e konfliktit që kanë bashkëshortët ndërmjet tyre, ka rezultuar se pala e humbur dhe më e pambrojtur, janë fëmijët.

Zgjidhja e martesës vërtet ndryshon kushtet dhe rrethanat në jetesën e përbashkët familjare, por ky fakt nuk duhet të ndikojë negativisht në mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijës.

Gjithashtu, bashkëjetesa ndërmjet një burri dhe një gruaje parashikohet në Kodin e Familjes dhe sjell pasoja ligjore. Në përputhje me Kodin e Familjes, bashkëjetesa përkufizohet si “...një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe

*vazhdueshmërie..*⁸. Në këtë kuptim, ligji nuk kërkon një periudhë të caktuar kohore që bashkëjetesa të sjellë pasoja ligjore, por duhet që ajo të ketë qenë e vazhdueshme dhe bashkëjetuesit të kenë formuar një familje fakti. Bashkëjetuesit janë të lirë të zgjedhin pasojat ligjore në lidhje me fëmijët e lindur nga kjo bashkëjetesë. Kjo mund të bëhet me anë të një marrëveshjeje paraprake⁹. Në marrëveshje përcaktohen pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës, duke mos përjashtuar edhe caktimin e detyrave dhe përgjegjësive prindërore ndaj fëmijëve, si dhe rregullimin e pasojave në rast ndarjeje. Në mungesë të një akt-marrëveshjeje paraprake apo/dhe mosmarrëveshjes të krijuar ndaj bashkëjetuesëve palët i drejtohen gjykatës, e cila vendos mbi pasojat e bashkëjetesës.

Raporti për politikën e pensionit ushqimor pas divorcit synon të sjellë një instrument të dedikuar për vlerësimin e ndikimit të politikave institucionale dhe gjyqësore që lidhen me të drejtat e fëmijëve.

Qëllimi

Studimi ka si qëllim të realizojë një analizë të detajuar të vendimeve të gjykatave, mbi përcaktimin e pagesave të detyrimit ushqimor, pas zgjidhjes së martesës. Në caktimin e pagesave për plotësimin e detyrimit për ushqim të fëmijëve, nga prindërit e tyre, gjykatat parimisht marrin në konsideratë disa nevoja për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, si dhe gjendjen ekonomike të prindit, që është i detyruar ta përmbushë detyrimin.

Në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është që të paraqesë indikatorët dhe të propozojë përmirësime për politikën ku mbështeten kryesisht gjykatat, për mënyrat e përcaktimit të pagesave të masës së detyrimit ushqimor për fëmijët, në rastet e zgjidhjes së martesës. Gjithashtu, studimi synon të fokusohet edhe në ndikimet që kanë patur këto vendimmarrje të institucioneve të drejtësisë në garantimin e një zhvillimi të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror dhe social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme dhe pa privime në interesin më të lartë të fëmijës.

Kuadri ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve është në proces të vazhdueshëm zhvillimi, me qëllim plotësimin dhe përmirësimin e këtyre të drejtave në zbatim të Kushtetutës së RSH-së dhe KDF-së.

Qëllimi është që çdo angazhim i qeverisë dhe i Parlamentit t'i shërbejë më së miri zhvillimit të perspektivës të mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve. Kjo, gjithmonë në

⁸ Neni 163 i Kodit të Familjes

⁹ Neni 164 i Kodit të Familjes

kuadër të zbatimit efektiv të KDF-së dhe, veçanërisht nën ndikimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, si një konsideratë parësore për të gjitha veprimet dhe vendimet që ndikojnë në mirëritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Gjithashtu, në këtë kontekst, duhet të kihet parasysh edhe Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, të cilat u referohen shprehimisht edhe fëmijëve.

Raporti synon të paraqesë një analizë të përgjithshme mbi bazën ligjore dhe arsyetimin ku mbështetet gjykata për caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijën, si dhe strukturën institucionale / ligjore për ekzekutimin e kësaj kategorie vendimesh.

Gjithashtu raporti paraqet edhe praktikën administrative të Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në përfitimin e pensionit ushqimor si një detyrim ligjor i prindërve.

Metodologjia

Raporti synon të paraqesë situata të vlerësimit gjyqësor të të drejtave të fëmijëve për plotësimin e nevojave që ata kanë për mirëritje, zhvillim, mirëqenie, edukim dhe arsim. Nevoja këto, që duhet të plotësohen nga prindërit edhe pas zgjidhjes së martesës apo bashkëjetesës. Studimi është bazuar në monitorimin dhe analizimin e vendimeve të marra nga institucionet gjyqësore, për mënyrat e përcaktimit të pagesave të masës së detyrimit ushqimor për fëmijët në rastet e zgjidhjes së martesës.

Për realizimin e këtij raporti është shfrytëzuar informacioni i mbledhur nga analiza e vendimnarrjeve gjyqësore me objekt “Zgjidhje e martesës» dhe “Rregullimi i pasojave të zgjidhjes së martesës”. Pjesë e monitorimit kanë qenë edhe gjetjet e evidentuara nga ankesat apo rastet e trajtuara me iniciativë nga institucioni i AP, me objekt “Dhënien e detyrimit ushqimor ndaj fëmijës”. Po kështu, është monitoruar edhe ZPSH mbi çështjet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor në favor të fëmijëve në rastet e zgjidhjeve të martesës.

Diversifikimi i burimeve të informacionit, është realizuar me qëllim që të identifikohen disa aspekte të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin në praktikë të legjislacionit familjar.

Rastet që u analizuan janë çështje të përfunduara mbi zgjidhjen e martesës, të gjykuara në:

- Gjykatat e rretheve gjyqësore në nivel kombëtar;
- Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;
- Gjykatën e Apelit, Tiranë (vendimet e kësaj të fundit janë të formës së prerë).

Realizimi i një raporti të tillë, që në fakt për nga natyra është unik në problematikën që ka trajtuar dhe rekomandimet që adresohen, ka kërkuar përfshirjen e një metodologjie shumëdimensionale. Përdorimi i instrumentave matës dhe tregues, është në funksion të përmbushjes të objektivave si vijon:

Së pari, në analizimin në disa dimensione të fenomenit nisur nga:

- a) hulumtimi i disa studimeve të ngjashme, të cilat janë bërë në fushën e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave familjare;
- b) statistikat sasiore të mbajtura nga gjykatat, AP dhe MD;
- c) statistikat cilësore të vendimmarrjeve të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe ekzekutimit të vendimeve nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror, Tiranë.

Së dyti, përgatitja e pyetësorëve dhe anketave të ndryshme në përputhje me modelin që do të përzgjidhet, duke intervistuar të divorcuarit me pyetje të hapura dhe të mbyllura, si dhe psikologët e angazhuar në raste të zgjidhjeve të martesës, me qëllim evidentimin e ndikimit të masës së detyrimit të pensionit ushqimor në mirëqënien, zhvillimin dhe mirërritjen e fëmijës.

Së treti, fokus grupe me gjyqtarët, për të marrë informacion mbi bazën ligjore, rrethanat dhe llogjikën gjyqësore për caktimin e masës së pensionit ushqimor.

Kombinimi i instrumentave të ndryshëm, sasiore dhe cilësore, vjen në funksion të krijimit të një hapësire për të mundësuar plotësimin e mangësive të konstatuara dhe arritjen e një rezultati sa më gjithëpërfshirës.

1. Kuadri ligjor lidhur me detyrimin ushqimor për fëmijët

Në shoqërinë tonë ka një diskutim të vazhdueshëm lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë. Legjislacioni shqiptar ka parashikuar disa mekanizma dhe organe përgjegjëse, të cilat synojnë të garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin dhe promovimin e këtyre të drejtave.

Bazuar në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, tashmë janë krijuar një sërë instrumentash në funksion të mbrojtjes së veçantë të fëmijës. Ky është një parim i rëndësishëm, pasi mbron të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme.

1.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e RSH (1998), e ndryshuar është akti themeltar që përcakton parimet kryesore të shtetit dhe të së drejtës. Legjislacioni shqiptar hartohet dhe strukturohet në bazë dhe në zbatim të saj. Një ndër parimet themelore të parashikuara në Kushtetutë, është parimi i barazisë së shtetasve. Të gjithë shtetasit shqiptarë trajtohen në mënyrë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diferencohet apo diskriminohet, padrejtësisht, për shkaqe të tilla si gjinia, mosha, etnia, besimi, arsimit, kultura, ekonomia, etj¹⁰.

Kushtetuta është garantuesja themelore e të drejtës së çdo individi për t'u martuar, për të krijuar një familje dhe për të pasur një jetë familjare, të drejta këto që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Dispozitat kushtetuese përcaktojnë si të domosdoshme ndërhyrjen e strukturave shtetërore për mbrojtjen e dy prej institucioneve më të rëndësishme të shoqërisë tonë, që lidhen me vetë ekzistencën e saj, martesën dhe familja. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familjen e tij, por është detyrë e shtetit që të ofrojë rregullimin dhe mbrojtjen ligjore të këtyre instituteve. Ligjvënësi dhe qeveria shqiptare kanë detyrimin që të marrin të gjitha masat e duhura për të rregulluar lidhjen dhe zgjidhjen e martesës¹¹.

Në Kushtetutë përcaktohet qartë se mbrojtje i jepet familjes të krijuar nga martesë, ashtu si edhe familjes të krijuar nga bashkëjetesa. Legjislatori e ka përcaktuar bashkëjetesën si një bashkim faktik të dy personave me gjini të ndryshme, që jetojnë në çift. Ky “bashkim i lirë” mes burrit dhe gruas, karakterizohet nga një jetesë e përbashkët, që paraqet qëndrueshmëri dhe vazhdueshmëri. Duke qenë se bashkëjetesa mes dy personave kërkon mirëkuptim të dyanshëm, ajo prodhon efekte juridike edhe mbi përgjegjësitë prindërore, në drejtim të fëmijëve të lindur nga ky bashkim.

Mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta gjen edhe familja e krijuar nga një nënë ose baba e/i pamartuar, duke garantuar shprehimisht barazinë e fëmijëve të lindur jashtë martesë me ata të lindur nga martesë. Çfarëdo statusi të kenë prindërit, të martuar

¹⁰ Shih neni 18 i Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë

¹¹ Shih neni 53 i Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë

ose jo, ata kanë përgjegjësi për edukimin, mirërritjen dhe mirëqënien e fëmijës për një zhvillim normal.

Po në konceptin e familjes, Kushtetuta trajton me përparësi edhe parimin që lidhet me mbrojtjen e veçantë të fëmijëve nga shteti¹². Nga ana ligjore, mbrojtja e fëmijëve është parë fillimisht duke ju siguruar atyre formalizimin e familjes. Pra shteti ndërhyr për garantimin e të drejtës për të pasur dhe njohur ligjërisht amësinë dhe atësinë, si dhe gëzimin real të së drejtës për një jetë familjare normale.

Mbrojtja e fëmijëve kërkon, që jo vetëm shteti, por të gjithë ne të marrim përgjegjësitë tona. Shoqëria jonë duhet të pranojë se çështjet e kujdesit dhe mirëqënies së fëmijëve janë thelbësore. Në këtë kuptim, KF, i cili rregullon në mënyrë të veçantë marrëdhëniet familjare dhe tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që kjo marrëdhënie krijon për palët, gjen plotësisht përputhje me konceptin kushtetues të familjes. Në këtë mënyrë, konstatojmë, se tërësia e dispozitave kushtetuese garanton të drejtën për të krijuar një familje, të drejtën për të jetuar me/në familje, të drejtën për të respektuar barazinë bashkëshortore lidhur me përgjegjësitë në familje, si dhe garantimin e mbrojtjes së posaçme të fëmijëve, përmes një kuadri ligjor në përputhje me këto dispozita.

1.2. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve

Konventa është një akt i rëndësishëm i të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Dispozitat e KDF nuk ofrojnë vetëm një panoramë të të drejtave të fëmijëve, por paraqesin edhe përgjegjësitë kundrejt fëmijëve, që shtetet të cilët e kanë ratifikuar Konventën duhet të jenë të gatshme t'i marrin përsipër dhe t'i zbatojnë

Në preambulën e saj KDF e cilëson familjen si baza e lirisë, drejtësisë dhe e paqes në botë. Që familja të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi, duhet të ketë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme nga strukturat shtetërore.

Familja është jo vetëm njësi themelore e shoqërisë, por dhe një mjedis natyror për rritjen dhe mirëqënien e të gjithë anëtarëve të saj veçanërisht të fëmijëve. Konventa pranon se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi. **Të gjithë strukturat ndërkombëtare duhet të organizohen dhe**

¹² Shih neni 54 i Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë

përpiqen që fëmija të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit.

Konventa paraqet një katalog të plotë të parimeve universale dhe të pakundërshtueshme, ku duhet të mbështeten të drejtat e fëmijëve në botë. Dispozitat e KDF legjitimojnë fëmijët si subjekte të të drejtave dhe si të tillë, duhet të respektohen në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe si pjesëmarrës në të gjitha çështjet që ndikojnë mbi ta. Konventa është një qasje që nga njëra anë synon të sfidojë perceptimin tradicional mbi statusin e fëmijëve si individë me rëndësi më të vogël se të rriturit dhe nga ana tjetër, synon të mbështesë parimin e të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët.

KDF përcakton edhe një tërësi detyrimesh dhe përgjegjësish, që duhet të mbahen në konsideratë për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Parimet e përgjithshme mbi të cilat janë bazuar përcaktimi i detyrimeve dhe përgjegjësive që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve janë:

- Barazia dhe mosdiskriminimi¹³;
- Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore. Shtetit duhet t'i sigurojë fëmijës mbrojtje dhe kujdes¹⁴;
- E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit¹⁵;
- Respektimi i mendimit të fëmijës¹⁶.

KDF pranon rëndësinë e informimit të vetë fëmijëve mbi të drejtat e tyre. Gjithashtu, shton ndjeshëm të drejtat për pjesëmarrje të fëmijës në jetën e tij private, në familje dhe në shtëpi.

KDF është i pari akt ndërkombëtar që prek tema të tilla si: e drejta e rehabilitimit për fëmijët të cilët kanë përjetuar situata traumatike dhe shfrytëzimin, detyrimi i qeverive për të zhdukur praktikat tradicionale, të dëmshme për shëndetin dhe personalitetin e fëmijëve¹⁷.

Shtetet që e kanë ratifikuar KDF kanë detyrimin të marrin masa legislative dhe administrative, si dhe të bëjnë gjithçka është e nevojshme për zbatimin e saj. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bazuar në fuqinë ekonomike shtetet palë

¹³ Shih neni 2 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

¹⁴ Shih neni 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

¹⁵ Shih neni 6 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

¹⁶ Shih neni 12 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

¹⁷ Shih neni 39 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

duhet të angazhohen maksimalisht për garantimin e realizimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve¹⁸.

KDF trajton edhe një sërë parimesh dhe cakton standarde, që kanë në fokus të tyre veçanërisht birësimin dhe gjykimin e të miturve¹⁹.

1.3 Konventa mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore²⁰

Kuadri ligjor i Konferencës së Hagës²¹, ratifikuar nga Shqipëria, lidhur me detyrimin për ushqim përmbledh:

- Konventën e Hagës mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore²², (e 2 Tetor 1973 që mban numrin 24).;
- Konventën e Hagës mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore²³, [e 2 Tetorit 1973 që mban numrin 23] dhe
- Konventa e Hagës ‘Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes²⁴ (e 23 Nëntorit 2007 që mban numrin 38)

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, marrin përsipër të vendosin/hartojnë ligjin e zbatueshëm për rastet e detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve.

KLZDU zbatohet për detyrimet ushqimore që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhje tjetër jo gjaku. Këtu përfshihet edhe detyrimi ushqimor ndaj një të mituri të lindur jashtë martese²⁵.

¹⁸ Shih neni 4 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

¹⁹ Shih neni 40 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve

²⁰ RSH ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr.10397 datë 17.3.2011, botuar në Fletoren Zyrtare nr.34 datë 07.04.2011. Hyri në fuqi më datë 01.11.2011

²¹ për tu njohur me gjithë Konventat e Hagës të ratifikuara nga Shqipëria, mund të aksesoni faqen <https://www.hcch.net/en/states/hcch-members/details1/?sid=18>

²²Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore’ bërë në Hagë më 2 tetor 1973; RSH ka aderuar në këtë konventë me ligjin nr.10397, datë 17.3.2011, botuar në Fletoren Zyrtare nr.34, datë 7.4.2011 dhe kjo konventë ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 2011.

²³ “Konventa mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”, bërë në Hagë më 2 tetor1973 Aderuar më 29.08.2011. Kjo konventë ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2011.

²⁴ Konventa e Hagës për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes, bërë në Hagë më 23 nëntor 2007 dhe ratifikuar nga RSH me ligjin nr.63/2012

²⁵ Shih neni 1 i Konventës mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore

Çdo shtet që ka aderuar në Konventë rezervon të drejtën për të zbatuar dispozitat që lidhen me përgjegjësinë për detyrimet ushqimore ndërmjet bashkëshortëve dhe ish – bashkëshortëve, si dhe në lidhje me një person që nuk ka arritur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk është i martuar²⁶.

Akti nuk ofron një përkufizim konkret të asaj që nënkuptohet me “detyrim ushqimore”, por zgjeron fushën e zbatimit ligjor në lidhje me raportet që janë produkt i marrëdhënieve familjare, të gjinisë, martesës ose përgjegjësisë prindërore. Praktikisht Konventa nuk jep një zgjidhje reale dhe konkrete lidhur me pyetjen – nëse dispozitat e saj garantojnë interesin më të lartë të fëmijës.

1.4 Konventa mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Detyrimet Ushqimore²⁷

Kuadri ligjor ndërkombëtar në sferën e detyrimeve ushqimore i njohur nga shteti shqiptar përfshin edhe KNJZVDU, që zbatohet për një vendim të dhënë nga një autoritet gjyqësor apo administrativ në një shtet aderues, në lidhje me një detyrim ushqimor që rrjedh nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhjeje tjetër jo gjaku. Këtu përfshihet edhe caktimi i një detyrimi ushqimor ndaj një të mituri, të lindur jashtë martese²⁸.

Një vendim i dhënë në një shtet i cili ka ratifikuar Konventën, njihet dhe/apo zbatohet në një shtet tjetër, që ka ratifikuar këtë Konventë nëse plotësohen dy kushte bazë. Kushti i parë lidhet me faktin nëse vendimi është dhënë nga një autoritet që konsiderohet të ketë juridiksion²⁹ në bazë të përcaktimeve të vetë Konventës dhe kushti i dytë nëse vendimi nuk u nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës.

Autoriteti i një shteti anëtar të Konventës, që ka dhënë vendim ndaj një pretendimi për detyrim ushqimor, konsiderohet se ka juridiksion për qëllimet e kësaj Konvente, nëse detyrimi ushqimor rrjedh për arsye të një zgjidhjeje martese ose ndarjeje ligjore, ose të një deklarate që një martesë është e pavlefshme ose e anuluar, të marrë nga

²⁶ Shih neni 24 i Konventës mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore

²⁷ RSH ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr.10398 datë 17.3.2011, botuar në Fletoren Zyrtare nr.34 datë 07.04.2011. Hyri në fuqi më datë 01.12.2012

²⁸ Shih neni 1 i Konventës mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Detyrimet Ushqimore

²⁹ Neni 7 i Konventës përcakton që - një autoritet në shtetin e origjinës do të konsiderohet se ka juridiksion kur:

– ofruesi i detyrimit ushqimor ose përfituesi i detyrimit ushqimor ka pasur vendqëndrimin e tij të zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur ka filluar procedimi,

– kur ofruesi i detyrimit ushqimor dhe përfituesi i detyrimit ushqimor janë shtetas të shtetit të origjinës në kohën kur ka filluar procedimi

– kur i padituri është mbrojtur bazuar në themel të çështjes pa kundërshtuar juridiksionin e autoritetit përkatës

autoriteti i atij shteti që njihet se ka juridiksion në këtë çështje sipas ligjit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.³⁰

Konventa përcakton qartë se autoriteti i shtetit, të cilit i drejtohet kërkesa është i detyruar të pranojë faktet e provuara mbi të cilat autoriteti i shtetit të origjinës ka bazuar juridiksionin e tij. Procedura për njohjen apo zbatimin e një vendimi për ekzekutimin e detyrimit ushqimor rregullohet nga ligji i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

Njohja apo zbatimi i pjesshëm i një vendimi mund të zbatohet në çdo rast.

Ratifikimi i konventave të sipërcituara i ofron garanci për mbështetje ndërkombëtare kundrejt forcimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve e konkretisht të detyrimit ushqimor ndaj tyre dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes. Kjo forcon edhe përmbushjen e detyrimit ushqimor në rastet e ushtrimit të të drejtës së përkujdesjes së prindërve ndaj fëmijëve që jetojnë në një vend të ndryshëm me atë të prindit debitor, jo ushtrues të përgjegjësisë prindërore. Në thelb Konventa kërkon me ngulm që prindi debitor (jo përgjegjës ligjërish për mirëritje dhe edukim) me një residencë në një vend të ndryshëm nga ajo e fëmijëve të mos bëhet shkak për mohimin e të drejtës së fëmijëve për të marrë detyrimin ushqimor, të cilin ky prind është ligjërish i detyruar ta përmbushë.

Shtetet që kanë ratifikuar Konventën, kanë të drejtën për të mos njohur ose zbatuar³¹:

- Një vendim ose marrëveshje në masën që kjo lidhet me një periudhë kohore pasi përfituesi i detyrimit ushqimor arrin moshën 21 vjeç ose martohet, përveç rasteve kur përfituesi është ose ka qenë bashkëshorti i ofruesit të detyrimit ushqimor;
- Një vendim ose marrëveshje në lidhje me detyrimet ushqimore ndërmjet: personave me lidhje fafëfisnore; personave me lidhje jo gjaku;
- Një vendim ose marrëveshje, nëse nuk parashikon pagesa periodike të detyrimit ushqimor.
- Një shtet kontraktues që ka bërë një rezervë nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e kësaj Konvente për vendime ose marrëveshje të tilla që përjashtohen nga rezerva e tij³²

1.5. Kodi i Familjes

³⁰ Shih neni 8 i Konventës mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Detyrimet Ushqimore

³¹ Shih përcaktimet e dhëna në nenet 26 dhe 34 të Konventës mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Detyrimet Ushqimore

³² Përcaktim i shprehur nga neni 26 i Konventës mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Detyrimet Ushqimore

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë³³ sanksionon të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore të cilat garantojnë, mbrojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet në marrëdhëniet familjare. Në respektim të Kushtetutës, KF garanton dhe konsideron parësore mbrojtjen e të miturit dhe interesin më të lartë të tij³⁴. Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës është një përgjegjësi që kërkon angazhimin e të gjithë institucioneve dhe mekanizmave.

Fëmija është bartës i të drejtave që kanë natyrë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Prandaj, legjislatori shqiptar i kushton një rëndësi të veçantë trajtimit të marrëdhënieve që ka fëmija me prindërit dhe me familjen e tij. Kjo ka si qëllim garantimin e mirëqënies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës të fëmijës, për të mundësuar zhvillimin e tij në shoqëri.

Në KF rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit, familja ose përfaqësuesit e tyre ligjorë ndaj fëmijëve. Prindërit kanë detyrime dhe përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre³⁵. Legjislatori i kushton të njëjtën vëmendje, si të drejtave prindërore në familje, ashtu dhe detyrimit të tyre për tu kujdesur për ushqimin dhe veshjen e fëmijës, arsimimin dhe edukimin e tij, etj.

Çdo fëmijë duhet të jetojë dhe të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe prindërit e kanë detyrim që tu garantojnë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, si dhe të kujdesen për rritjen dhe edukimin e tyre.

Dispozita konkrete të KF paraqesin qartë, që në çdo rast, të respektohet parimi i barazisë dhe mosdiferencimit të fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë. Ky parim kushtetues³⁶ gjen rregullim të gjerë në KF³⁷. Sipas këtij parimi, nuk duhet të bëhet asnjë dallim në të drejtat e fëmijëve duke marrë për bazë faktin, nëse ata janë të lindur në martesë apo jashtë martesë. Prindërit kanë detyrim dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre, të lindur nga martesë ose jashtë martesë. Pra, detyrimi ligjor për të plotësuar

³³ Ligj nr.9062, date 8.5.2003, “Kodi i Familjes”

³⁴ Shih nenin 2 KF, i cili përcakton se: “...Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës...”

³⁵ Shih neni 3 i KF

³⁶ Shih neni 54/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

³⁷ Shih nenet që lidhen me njohjen e amësisë dhe atësisë, të fëmijës të lindur jashtë martesë (167, 170, 181, 182); nenet që lidhen me mbiemrin e fëmijës të lindur jashtë martesë (171); nenet mbi përgjegjësinë prindërore (220, 221)

nevojat e fëmijëve prodhon efekte të pakundërshtueshme tek prindërit e tij edhe pse nuk janë të lidhur në martesë³⁸.

Martesa përbën një ngjarje të rëndësishme shoqërore dhe juridike në jetën e njeriut. KF nuk jep ndonjë përkufizim të drejtëpërdrejtë për martesën, por e paraqet si një bashkësi ligjore e krijuar mbi disa parime. Martesa është një bashkim ligjor dhe i vullnetshëm, që mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Në martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime. Pra, martesa është një akt juridik tipik dhe solemn që krijon detyrime reciproke për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të jetesës së përbashkët.³⁹

Gjatë jetesës të përbashkët bashkëshortët mund të ndeshin në vështirësi dhe probleme të ndryshme, të cilat mund të bëhen shkak për zgjidhjen e martesës. Sido që të jetë vullneti i bashkëshortëve për t'u ndarë, mundësia e vetme për ta bërë është që ky akt të realizohet në bazë të ligjit dhe në vlerësimin e gjykatës⁴⁰. Çështjet që kanë të bëjnë me zgjidhjen e martesës janë kompetencë lëndore e seksionit familjar të gjykatës së rrethit gjyqësor, ku palët banojnë ose kanë lidhur martesën.

Gjykata vlerëson me objektivitet dhe më pas vendos zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Marrëveshja, ndër të tjera, duhet të përmbajë edhe rregulla në lidhje me lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore.⁴¹

Gjykimi i kërkesës për zgjidhjen e martesës është një gjykim me palë kundërshtare dhe, vihet në lëvizje me paraqitjen e padisë nga bashkëshorti paditës. Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.⁴² Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër.⁴³

³⁸ Shih neni 4 i KF

³⁹ Shih neni 50 KF

⁴⁰ Shih nenet 125, 126, 128, 129 dhe 131 të KF.

⁴¹ Referimi është bërë bazuar në formulimin e dhënë në nenin 127 të Kodit të Familjes

⁴² Shih nenin 132 KF

⁴³ Shih nenin 133 KF

Në rast se gjatë martesës kanë lindur fëmijë, bashkë me kërkesën për zgjidhjen e martesës bashkëshortët mund të paraqesin edhe kërkesa të tjera që lidhen me detyrimin e bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve⁴⁴. Para se gjykata të marrë një vendim, lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit bashkëshort, duhet të thërrasë edhe një psikolog ose punonjës social, i cili duhet të japë mendim⁴⁵. Psikologu duke përdorur aftësitë e tij profesionale, duhet të bëjë një analizë dhe vlerësim të të miturit, në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij mendor, si dhe situatën e tij sociale. Në këtë mënyrë prindi të cilit i është caktuar përgjegjësia prindërore me vendim gjykate duhet ti krijojë fëmijës kushte të mira familjare dhe shpirtërore, një ambient të qëndrueshëm, si dhe të tregojë një përkujdesje dhe përkushtim më të madh lidhur me këtë fakt.

Ndërkohë, KF parashikon që, prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, duhet të krijojë lidhje afektive me fëmijën duke patur një kontakt të shpeshtë me të, si dhe detyrohet të kontribuojë në rritjen dhe edukimin e fëmijës së tij. Kuptohet që diçka e tillë duhet bërë duke patur parasysh edhe kushtet dhe gjendjen faktike familjare, si dhe nivelin ekonomik – financiar të prindërve ndërsa interesi parësor është ai i fëmijëve⁴⁶.

Në vendimin e zgjidhjes së martesës duhet të caktohet edhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën. Në dispozitat e KF nuk ka të përcaktuar një shumë minimale apo mesatare, të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me fëmijën. Por, diçka e tillë lihet në shqyrtim të gjykatës, e cila bazohet në informacionin e paraqitur nga palët⁴⁷. Edhe në rast se palët nuk paraqesin kërkesë për detyrim ushqimor për fëmijën, sërish gjykata ajo që vendos, pasi kontributi material është i një rëndësie parësore për mirërritjen e fëmijës. Ndaj, ligji ka konsideruar, që përcaktimi i tij nuk mund t'i lihet ekskluzivisht prindërve të fëmijës. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës imponon ndërhyrjen e gjykatës, e cila sipas rastit, duhet të zgjidhë edhe konfliktin ndërmjet prindërve, nëse ata nuk bien dakord mbi masën e këtij detyrimi.

Çdonjëri prej ish – bashkëshortëve është i detyruar, që t'i japë tjetrit, të dhëna të sakta për pasurinë dhe të ardhurat e tij, kur ato janë të nevojshme për të caktuar detyrimin për ushqim. Gjykata në vendimmarrjen e saj për caktimin e detyrimit për

⁴⁴ Shih neni 138 i KF

⁴⁵ Shih neni 155 – 157 i KF

⁴⁶ Shih neni 158 i KF

⁴⁷ Shih neni 161 i KF

ushqim, duhet të orientohet jo vetëm në plotësimin e nevojave të fëmijës, por edhe në nevojat dhe mundësitë ekonomike të prindit që detyrohet të paguajë⁴⁸.

Si përfundim, prindërit kanë përgjegjësi ndaj fëmijëve të tyre. Kjo përgjegjësi përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave prindërore, që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqënien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës. Gjithashtu prindërit duhet të kujdesen për fëmijët e tyre, duke mbajtur raporte vetjake me ta, duke i siguruar atyre mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tyre.

Dy institucionet më të rëndësishme të shoqërisë që lidhen me vetë ekzistencën e saj, siç janë martesat dhe familja, mbrohen nga Kushtetuta e RSH⁴⁹. Në këtë mënyrë Kushtetuta mbron si familjen e krijuar nga martesat, ashtu si dhe familjen e krijuar nga bashkëjetesa ose “bashkimit të lirë” të dy personave me gjini të ndryshme. Mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta gjen edhe familja e krijuar nga një nënë ose baba e/i pamartuar, duke garantuar shprehimisht barazinë e fëmijëve të lindur jashtë martesë me ata të lindurit nga martesat. Po në konceptin e familjes, Kushtetuta vendos menjëherë pas nenit 53, një nen që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve, sipas të cilit ata gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti⁵⁰. Mbrojtja e fëmijëve nga ana ligjore është parë fillimisht duke ju siguruar atyre formalizimin e familjes, pra të drejtën për të pasur të njohur ligjërisht amësinë dhe atësinë si dhe gëzimin real të së drejtës për një jetë familjare normale. Në këtë kuptim, koncepti kushtetues i familjes gjen plotësisht përputhje me KF i cili rregullon në mënyrë të veçantë marrëdhëniet familjare dhe tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që kjo marrëdhënie prodhon për palët.

1.6. Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Ligji nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, sjell një qasje tjetër ndaj mënyrës se si konceptohen të drejtat e fëmijës, cilat grupe fëmijësh janë veçanërisht në fokus të sistemit të integruar të mbrojtjes, si dhe masat konkrete të mbrojtjes që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar ose mbrojtur në vazhdimësi fëmijën që është subjekt i dhunës, abuzimit, neglizhimit ose potencialisht i tillë.

⁴⁸ Shih neni 201 i KF

⁴⁹ Ne përputhje me nenin 53 të Kushtetutës së RSH-së

⁵⁰ Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: 1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesat. 3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Legjislatori ka në fokus të tij përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e veçantë që gëzon çdo fëmijë. Gjithashtu, me anë të dispozitave ligjore synohet të përcaktohen mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që duhet të angazhohen për të garantuar me efektivitet ushtrimin, respektimin dhe promovimin e këtyre të drejtave⁵¹.

Qëllimi i LDMF, konsiston në mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këte fushë. Hartimi i politikave kombëtare për të drejtat e fëmijës, ndikon në krijimin e mekanizmave efikase dhe caktimin e autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror e vendor, që duhet të angazhohen në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës. Strukturat shtetërore duhet të ndihmojnë dhe të përkujdesen për fëmijën, pasi fëmijët janë pjesa më vulnerabël e shoqërisë, dhe rrjedhimisht ndaj çështjeve të shëndetit dhe mirëqënies së tyre duhet të kihet një vëmendje e veçantë. .,

Ligji mbështetet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke synuar garantimin e mirëqënies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e personalitetit të tyre në shoqëri.

E gjitha kjo mund të arrihet vetëm si rezultat i bashkëpunimit, ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës. Qëllimi është ngritja e një sistemi të integruar dhe funksional për mbrojtjen e fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit⁵².

Ndër parimet e tjera, shtylla të LDMF, janë dhe ato të barazisë dhe eliminimit të të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinionëve të shprehura apo të bindjeve të prindit ose kujdestarit, ose të anëtarëve të familjes.

Ligji garanton respektimin e përgjegjësive parësore, të prindit ose kujdestarit, për t'i krijuar fëmijës kushtet më të mira të mundshme të jetesës, si dhe për t'i garantuar atij mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin. Çdo fëmijë duhet të jetojë dhe të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar ku t'i respektohet dinjiteti, nderi dhe personaliteti⁵³.

⁵¹ Neni 1 i Ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

⁵² Neni 2 i Ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

⁵³ Neni 5 i Ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

LDMF legjitimon të drejtën që ka fëmija për të qëndruar/jetuar pranë prindërve të tij, si dhe mos - ndarjen prej tyre. Përjashtime nga ky parim, mund të bëhen vetëm kur një gjë e tillë është vlerësuar nga gjykata, e cila vendimmarrjen e saj duhet ta bëjë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike e prindërve në asnjë rast nuk duhet të jetë shkak i mjaftueshëm, që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore⁵⁴.

Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm në përputhje me zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Mirërritja dhe edukimi i fëmijës është një detyrim që i takon prindit ose kujdestarit, pasi kanë detyrimin dhe përgjegjësinë parësore për t'i siguruar, brenda aftësive dhe mundësive financiare që ata kanë, kushtet më të mira të jetesës, të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.⁵⁵

Për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, prindi apo kujdestari kanë mundësi dhe hapësira ligjore të kërkojnë nga autoritetet shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar, për të garantuar mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.

2. Garancitë juridiksionale

Parimi i shtetit të së drejtës është i lidhur ngushtë me mirëfunksionimin e pavarur të pushtetit gjyqësor, i cili si një prej funksioneve të shtetit, garanton mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e akteve normative. Kushtetuta bën një rregullim të plotë të garancive juridiksionale në Shqipëri. Në funksion të kësaj, gjykatat kanë një funksion të trefishtë që lidhet me respektimin e hierarkisë së normave juridike, interpretimin dhe zbatimin e së drejtës.

Interpretimi i normës juridike ka kufij të gjerë përzgjedhjeje, pasi jo gjithmonë përmbajtja e normës është e thjeshtë apo me një kuptim. Shpeshherë, mund të lindin kundërshti gjatë interpretimit të saj. Prandaj, nga kjo pikëpamje, roli i gjykatave kombëtare për interpretimin e legjislacionit të brendshëm të RSH-së, sidomos në çështjet e fëmijëve, është mjaft i rëndësishëm.

⁵⁴ Neni 9 i Ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

⁵⁵ Neni 20 i Ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

2.1. Roli i gjykatave

Gjykata në mosmarrëveshjet për zgjidhjen e martesës apo në procedurat e veçanta lidhur me pagesën e ushqimit duhet të caktojë shumën/masën konkrete të pagesës. Në praktikë, lidhur me caktimin e nevojave të përgjithshme për pensionin ushqimor mund të paraqiten vështirësi, në rastet kur i padituri nuk ka mundësi materiale që t'i përmbushë ato nevoja. Vlera e ushqimit caktohet në përpjesëtim me aftësitë dhe mundësitë e bashkëshortit, i cili është i detyruar të paguajë pensionin ushqimor brenda kufijve të nevojave të paditësit. Gjykata, në çdo rast konkret, duhet t'i vlerësojë nevojat e paditësit-kërkuesit të ushqimit, gjithnjë duke pasur parasysh gjendjen e tij financiare dhe pasurore, aftësinë për të punuar, gjendjen shëndetësore, nevojat personale, si edhe rrethana të tjera me ndikim në caktimin e masës së ushqimit.

Në rastet kur kërkohet pagesa e ushqimit për fëmijët e mitur, ka rëndësi edhe mosha e fëmijës, nevojat për edukim dhe arsimim profesional, gjendja shëndetësore e tij, si edhe rrethana tjera. Në rastin e vlerësimit të mundësive të bashkëshortit, nga i cili kërkohet pagesa e ushqimit, gjykata duhet t'i ketë parasysh të gjitha të ardhurat, që realizon ai, si të ardhurat e rregullta mujore, ashtu edhe ato periodike (të ardhurat nga puna në teren, nga bujqësia, honorari i autorit dhe të tjera). Nga ana tjetër, në mënyrë të njëjtë, për shkak të ndryshimit të rrethanave duhen vlerësuar dhe shqyrtuar edhe rastet që lidhen me zvogëlimin eventuale të të ardhurave për shkak të sëmundjes, paaftësisë së përkohshme për punë, pushimit mjekësor dhe raste të tjera të ngjashme. Në praktikë ndodhin raste me përpjekje për t'iu shmangur detyrimit apo me qëllim që ai të jetë sa më i ulët, ndaj duhet të kihet parasysh se bashkëshorti, nga i cili kërkohet ushqimi, mund të bëjë veprime të ndryshme me qëllim të zvogëlimit të të ardhurave të tij gjatë zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit, si duke tjetërsuar pasurinë, ashtu edhe duke fshehur të ardhurat e tij. Për këtë arsye gjykata, në rastet kur vendos lidhur me ushqimin duhet t'i vlerësojë dhe t'i shqyrtojë të gjitha faktet, jo vetëm në momentin e dhënies së vendimit për ushqimin, por për një kohë të mëparshme, më të gjatë. Në rastet e vlerësimit të mundësive për të kontribuar në ushqimin e fëmijëve, gjykata duhet të vlerësojë edhe mundësitë reale për realizimin e të ardhurave nga bashkëshorti, të cilit i kërkohet ushqimi, nevojat e tij personale dhe detyrimet e tjera për ushqim që ka ndaj personave të tjerë, me të cilët jeton. Parimi i përgjithshëm është se prindërit janë të detyruar të kontribuojnë për ushqimin e fëmijëve edhe në rastet kur rrezikojnë mjetet e tyre financiare, edhe sikur të keqësohet gjendja e tyre materiale. Masa e kontributit për ushqimin e fëmijëve varet, nga njëra anë, nga mundësitë financiare të prindit dhe nga ana tjetër, nga nevojat e fëmijës.

Kërkimi i detyrimit ushqimor në një masë të caktuar nga pala paditëse është i lidhur me shpenzimet e rritjes së fëmijës, moshën, arsimin, nevojat shëndetësore, etj. Gjykata e bazon vendimmarrjen e saj në nevojat e fëmijës për veshje, ushqim dhe arsimim, mundësitë ekonomike të palës paditëse, mundësitë ekonomike të palës së paditur si edhe nivelin e jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit. Gjykata kur jep vendimin e saj në lidhje me detyrimin ushqimor mbështetet në prova si: vërtetim mbi të ardhurat e palëve, vërtetim nga shkolla e fëmijëve, raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve, vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore si edhe dokumente të tjera të konsideruara me rëndësi si Certifikata, Dëshmi hipotekore, Marrëveshje, Kredi dhe vendime të lëshimit të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ose të Urdhrit të Mbrojtjes.

Është për t'u vlerësuar kujdesi i gjykatës sa i përket nivelit të jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit, me qëllim ruajtjen e këtij niveli jetese në emër të interesit më të lartë të fëmijës. Arsye të tjera që gjykata konsideron janë: minimumi i të ardhurave për frymë në vendin tonë, puna informale e palëve, statusi i ri familjar i njërës prej palëve gjyqësore, lindja e një fëmije tjetër nga martesë e re, papunësia, gjendja shëndetësore e palëve, etj

Në politikën mbi pensionin ushqimor pas divorcit, roli i gjykatave shfaqet veçanërisht në interpretimin e procesit të rregullt ligjor për ekzekutimin e vendimeve për detyrimin për ushqim. Në një analizë të përgjithshme konstatojmë, se gjykatat kanë krijuar praktika të rëndësishme për caktimin e detyrimit ushqimor dhe masën e kontributit të tij.

Nga monitorimi i bërë në gjykatat e rretheve gjyqësore në nivel kombëtar, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, mbi vendimmarrjen e gjykatës për caktimin e detyrimit ushqimor, rezulton se gjykatat janë bazuar në parimin e mbrojtjes së interesit të fëmijëve, si interesi më i lartë.

Sidoqoftë, praktikën kanë qenë të ndryshme dhe nuk ka ndonjë unifikim të faktorëve, tek të cilët duhet të bazohet gjykata për të dhënë masën e detyrimit për ushqim. Kjo mangësi krijon vështirësi sidomos kur kërkohet ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor për fëmijët.

Gjykata e Lartë e Shqipërisë ka vendosur, që çdo ndryshim i masës së pensionit ushqimor për fëmijët, duhet të bëhet nga gjykata e vendit ku banojnë fëmijët, me qëllim që të ketë një shqyrtim më të mirë të kushteve dhe rrethanave ku ata jetojnë.

Është e rëndësishme që gjykatat të krijojnë një praktikë ndihmuese për të reduktuar rastet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, gjë që ato e kanë elaboruar sidomos, në çështjet me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore. Këtu ka vend për të ngritur një sërë shqetësimesh, por mbi të gjitha vlen të theksohet fakti që gjyqtarët në dhënien e vendimit, duhet të marrin në konsideratë edhe faktorët ekonomik - sociale, formale dhe informale, me qëllim që të japin një vendim efektiv dhe të zbatueshëm.

Gjykata duhet të shprehet edhe për mënyrën e ekzekutimit të vendimmarrjes për caktimin e detyrimit ushqimor, me qëllim që vendimi të jetë realisht i zbatueshëm. Në këtë aspekt, një rol parësor ka drejtësia kushtetuese. Kërkesat për konstatimin e cenimit për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese janë trajtuar në këndvështrim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke e legjitimuar individin në këtë drejtim, për shkak se legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Këto vendime kanë patur më tepër karakter deklarativ/konstatues, se sa karakter efektiv për të ndihmuar procesin dhe rivendosur në vend të drejtën e shkelur. Megjithatë, me ndryshimet që i janë bërë KPrC-së me ligjin nr.38/20107 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 05.11.2017) është përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (nenet 399/7) etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive, me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, apo edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

Mund të themi se, në çështjet objekt studimi, nuk ka ende një jurisprudencë gjyqësore për të shmangur rastet e mosekzekutimit të vendimeve për detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve, brenda një afati të arsyeshëm. Kjo ka ndodhur, jo vetëm për shkak të mungesës së sanksioneve ligjore, por edhe për faktin se në vendimmarrje nuk saktësohen siç duhet, përgjegjësitë institucionale.

2.2. Vështrim i përgjithshëm i vendimmarrjes së gjykatave

Në shoqërinë tonë vazhdimisht diskutohet mbi situatat dhe kushtet e vështira ekonomike të grave pas zgjidhjes së martesës, sidomos kur në strukturë familjare ka edhe fëmijë. Në pjesën më të madhe të rasteve, fëmija i besohet kryesisht nënës për rritje dhe edukim, si ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore, ndërsa i ati i fëmijës detyrohet të paguajë një pension ushqimor.


Përgjegjësinë parësore për të siguruar, brenda mundësive dhe mjeteve financiare, kushtet e jetesës të nevojshme për zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit e tij, apo personat e tjerë përgjegjës për fëmijën.

Një diskutim tjetër mbi situatën dhe pafuqinë ekonomike bëhet edhe për nënat e pamartuara.

Nga një monitorim i vendimeve gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, në në Tiranë dhe në nivel kombëtar, rezulton se për vitin 2019, janë trajtuar 7502 padi me objekt “Zgjidhje martese”. Nga këto, 2416, pra 32% e tyre, janë padi me objekt “Zgjidhje martese dhe rregullim i pasojave të saj lidhur me caktimin e pensionit ushqimor për fëmijët”

Vlerat statistikore tregojnë se të paktën 32 % e rasteve ku kërkohet zgjidhja e martesës janë familje në strukturë të cilave ka edhe fëmijë.


Grafiku i mëposhtëm, paraqet skematikisht të dhënat e përpunuara si vijon:



Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, në Tiranë dhe në nivel kombëtar, rezulton se për vitin 2020, janë trajtuar 4943 padi me objekt “Zgjidhje martese”. Nga këto, 1239 janë padi me objekt “Zgjidhje martese dhe rregullim i pasojave të saj lidhur me caktimin e pensionit ushqimor për fëmijët”.

Pra rezulton, se 25 % e padive për zgjidhje martese në nivel kombëtar, janë padi me objekt “Zgjidhje martese dhe rregullim i pasojave të saj lidhur me caktimin e pensionit ushqimor për fëmijët”. Vlerat statistikore tregojnë, se të paktën 25 % e rasteve ku kërkohet zgjidhja e martesës janë familje në strukturë të të cilave ka edhe fëmijë.


Më poshtë, grafiku përkatës:



Nëse do të analizojmë në mënyrë krahasuese gjendjen mes vitit 2019 – 2020, do të konstatojmë, se për vitin 2020 ka një ulje të konsiderueshme lidhur me divorcet e familjeve që kanë në strukturën e tyre fëmijë.

Paditë me objekt “Zgjidhje martese dhe rregullim i pasojave të saj lidhur me caktimin e pensionit ushqimor për fëmijët”, për vitin 2020 janë 7 % më të ulëta se ato të vitit 2019.

Pra për vitin 2020, ka më pak raste të divorceve të familjeve, që në strukturë të tyre kanë edhe fëmijë.



A – Nga analiza procedurale e vendimmarrjeve të gjykatës konstatohet se:

1. Gjykata përpiqet të parashikojë fillimisht në mënyrë shteruese mundësinë për pajtim. Nëse nuk arrihet pajtimi, atëherë gjykata përfundon me një përcaktim të përgjithshëm të shkaqeve që justifikojnë ngritjen e padisë nga njëri apo dhe të dy bashkëshortët për zgjidhjen e martesës. Pra, gjykata duhet të krijojë plotësisht bindjen, se jetesa e përbashkët midis dy bashkëshortëve është bërë e pamundur dhe se martesa e ka humbur qëllimin e saj.
2. Në përfundim të gjykimit, pavarësisht debateve, palët kanë tendencën për të unifikuar pretendimet e tyre, duke kërkuar që të zgjidhet martesa mes tyre. Arsyetimi është thujse i njëjtë, martesa është formale dhe nuk arrin të prodhojë realisht asnjë nga funksionet e saj ekonomike, biologjike, morale dhe sociale. Pra, palët bien dakort që martesa mes tyre e ka humbur plotësisht qëllimin për të cilin është lidhur.
3. Me zgjidhjen e martesës cilësia e bashkëshortëve kthehet në “ish-bashkëshortë”, por cilësia e secilit prindit në raport me fëmijët e tyre nuk ndryshon. Duke u bazuar në raportet ndërpersonale prind – fëmijë,

përgjegjësia prindërore nuk cenohet nga zgjidhja e martesës. Bazuar në parimin e “*interesit më të lartë të fëmijës*”, gjykata bën një vlerësim rast pas rast, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, për respektimin ose jo të këtij parimi themeltar. Vlerësimi është i ndërthurur edhe në vartësi të mundësive materiale të prindërve, të mundësive të zhvillimit fizik, moral e intelektual të fëmijës, të pjekurisë së tij në konceptimin e situatës dhe të zgjidhjeve që ai shpreh nëpërmjet mendimit të tij.

4. Gjykata para marrjes së një vendimi përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, si dhe lidhur me të drejtën e vizitës të prindërit që nuk do t’i lihet fëmija për rritje dhe edukim, ka detyrimin ligjor të thërrasë ekspert psikolog⁵⁶. Qëllimi është garantimi tek të miturit, jo vetëm i gjendjes së duhur psiko–emocionale gjatë shprehjes së mendimit, por edhe vlerësimi i marrëdhënieve brenda familjes, si dhe përcaktimi i aftësisë prindërore të dy bashkëshortëve.
5. Gjykata, para se të vendosë për prindin që do të kujdeset për fëmijën, duhet të vlerësojë në tërësi provat e marra në gjykim si: pohimet e palëve, mendimin dhe dëshirat e fëmijës, mendimin e psikologes, moshën e fëmijës të mitur, lidhjet dhe afeksionin që ata kanë me secilin nga prindërit, etj.
6. Detyrimi ushqimor gjatë proceseve gjyqësore, të cilat mund të zgjasin edhe për një afat të paarsyeshëm, nuk zbatohet duke rënë ndesh me interesat e të miturit për t’i siguruar një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij. Në rastin kur prindërit zgjidhin martesën, Gjykata në vendimin e saj për zgjidhjen e martesës duhet të përcaktojë një masë paraprake për detyrimin ushqimor që duhet të paguajë prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim.
7. Gjykata në përgjithësi përcakton masën e detyrimi ushqimor që nuk është në përputhje me standadet e KDF për të siguruar rritjen dhe edukimin e fëmijës. Në pjesën më të madhe të rasteve vendimet e gjykatës nuk japin argumentet e nevojshme për të justifikuar përcaktimin e masës së pensionit ushqimor. Në raste të tjera ka vështirësi të provohen të ardhurat që siguron prindi, i cili nuk e ka fëmijën në ngarkim, por që duhet të paguajë detyrimin për ushqim. Kjo ndodh për faktin se një numër i konsiderueshëm personash nuk regjistrojnë aktivitetin e tyre sipas kërkesave të ligjit, ose nuk kanë lidhur kontratë për punën që kryejnë. Sigurisht, kjo bie ndesh me interesat e të miturit për t’i

⁵⁶ Konform nenit 155 të Kodit të Familjes

siguruar një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

B – Baza ligjore e përdorur në vendimmarrjen e gjykatave

Baza ligjore e përdorur në vendimmarrjen e gjykatave arsyetohet në interpretim me interesin parësor të fëmijës dhe është thujtë e njëjtë. Gjyqtarët kanë caktuar një standard, lidhur me legjislacionin e zbatueshëm për caktimin e prindit kujdestar dhe për caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijën.

Për të zgjidhur çështjet me objekt gjykimi “Zgjidhje martese dhe rregullim i pasojave të saj lidhur me caktimin e pensionit ushqimor për fëmijët” gjyqtarët përdorin në mënyrë të vazhdueshme këto dispozita ligjore: “*Nenet 3 dhe 12 të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijëve”*; *Nenet 2, 5, 6, 155, 157, 159, 192, 197, 198 të Kodit të Familjes*”.

Konkretisht, në këto dispozita është parashikuar:

- Neni 3 i Konventës: *“Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore ...”*
- Neni 12 i Konventës: *“Fëmija ka të drejtë për t’i shprehur lirisht pikëpamjet e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të dhe këto duhet të vlerësohen në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij”.*
- Neni 2 i KF: *“Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”.*
- Neni 5 i KF *“Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi”.*
- Neni 6 i KF: *“Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohet, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij. I mituri mund të dëgjohet vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij. Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale”.*
- Neni 155 i KF: *“Para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, duhet të*

thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija”.

- Neni 156 i KF: *“Gjykata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose për t’i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njërës prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurorit, në rast se ka shkaqe të rënda që janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore”.*
- Neni 157 i KF: *“Gjyqtari, në këtë rast, merr në konsideratë: a) marrëveshjen e bërë ndërmjet ish-bashkëshortëve; b) mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij; c) mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën”.*
- Neni 192 i KF *“Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës...b) prindërit ndaj fëmijëve të tyre...”*
- Neni 197 i KF: *“Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim dhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç”.*
- Neni 198 i KF: *“Detyrimi për ushqim lind vetëm kur personi që kërkon këtë detyrim është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar”.*

Nga monitorimi në gjykatat e rretheve gjyqësore në Tiranë dhe në nivel kombëtar, është vërejtur, se ka shumë padi që kanë si objekt gjykimi “Detyrimin për të paguar pension ushqimor për fëmijën”, të cilat ngrihen nga nënat. Këto janë padi që burojnë kryesisht nga prindër, të cilët kanë bashkëjetuar. Statistikat e gjykatave mbi këto lloj padish mungojnë, prandaj dhe nuk është mundësia për t’u monitoruar në mënyrë më të plotë. Avokati i Popullit rekomandon mbledhjen e statistikave në këtë drejtim për të pasur një kuadër më të qartë të numrit të këtyre padive.

Nga rastet e evidentuara për të zgjidhur çështjet me objekt gjykimi “Detyrimin e prindit debitor të paguajë pensionin ushqimor për fëmijën”, gjyqtarët përdorin si dispozitat ligjore të listuara më sipër, ashtu edhe nenet 3 dhe 4 të KF:

Konkretisht, në këto dispozita është parashikuar si vijon:

- Neni 3 i KF: *“Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë”*.
- Neni 4 i KF: *“Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si dhe fëmijët e lindur nga martesë”*.

C – Caktimi i masës së kontributit për pensionin ushqimor

Është detyrimi i prindërve për të kontribuar në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre si pjesë e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore që u takon atyre, pavarësisht zgjidhjes së martesës. Kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën nuk përfshihet në pasojat me karakter subjektiv të zgjidhjes së martesës dhe zgjidhen nga gjykata, vetëm nëse bashkëshorti i kërkon ato.

Parimisht, me vendimin e zgjidhjes së martesës, gjykata cakton se cili prind do të jetë kujdestar i fëmijës dhe masën e kontributit për detyrimin ushqimor për fëmijën⁵⁷.

Interesi më i lartë i fëmijës kërkon, që gjykata të vendosë për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, që përfshin përveç lënies për rritje dhe edukim të fëmijës, të drejtën e takimit të prindit tjetër dhe kontribuimin e prindit tjetër në rritjen e fëmijës. Gjkata mbështet faktin që prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës dhe për pasojë duhet të informohet për zgjidhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër⁵⁸. Megjithatë, Avokati i Popullit, vlerëson se gjykata në rastet e caktimit të kontributit për pension prindëror duhet të ketë parasysh jo vetëm burimet e të ardhurave të prindërve, por mbi të gjitha nevojat e vetë fëmijës, në mënyrë që të realizohet efektivisht interesi më i lartë i tij. Pra, nëse burimet e të ardhurave të prindërve nuk i përmbushin nevojat e fëmijës, atëherë shteti duhet të marrë masa për të kompensuar pjesën e të ardhurave që duhet për të përballuar nevojat e fëmijës.

Nga monitorimi i bërë, rezulton se gjyqtarët kanë përcaktuar një standard lidhur me caktimin e masës së kontributit, që prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, duhet të paguajë. Gjkqtarët gjithmonë arsyetojnë, se gjykata në përpjesëtim me gjendjen ekonomike të çdo prindi si dhe me nevojat e fëmijës për rritje dhe edukim, në përputhje me moshën e tij, cakton vlerën e pensionit ushqimor.

⁵⁷ Shih neni 161 i KF

⁵⁸ Shih neni 158 i KF

Arsyet se ku mbështetet gjykata në caktimin e kujdestarisë prindërore dhe caktimin e masës të pensionit ushqimor janë të lidhura me shumë prova të natyrës faktike si:

- gjendja ekonomike e prindit kujdestar; gjendja ekonomike e prindit debitor
- moshja e fëmijës/ve, arsimimi i fëmijës/ve, mirërritja e fëmijës/ve, gjendja shëndetësore e fëmijës/ve;
- ndryshimi i kushteve sociale të prindit kujdestar; ndryshimi i kushteve sociale të prindit debitor;
- moshja aktive për punë e të dy prindërve, si dhe nëse gëzojnë shëndet të plotë.
- kostoja monetare që kërkon rritja dhe edukimi i një fëmijës/ve;
- paga e secilit prind/gjendja e llogarive bankare në emër të prindit debitor.

Megjithatë, nga analiza e vendimeve të shqyrtuara për efekt të këtij raporti gjyqtarët në caktimin e detyrimit për ushqim për fëmijën, mbështeten tek elementë të tillë si: raporti ndërmjet minimumit jetik dhe rritjes së kërkesave në kushtet e rritjes së inflacionit dhe ndryshimit të ndjeshëm në rritjen e çmimeve e standardeve të jetesës.

Nga ana tjetër, gjykata merr në konsideratë burimin e të ardhurave me të cilat siguron jetesën secili prind dhe mundësinë ekonomike, pritshmërinë dhe mundësinë për punësim të secilit prej tyre, në raport me nevojat e fëmijëve. Nevojat e fëmijës vlerësohen në rastin konkret nga moshja, gjendja shëndetësore, niveli i intelektit dhe zhvillimi i tij psiko – motor aktual, si dhe niveli i nevojave për një zhvillim të mirë, edukim dhe arsimim të përshtatshëm për të. Gjithashtu, gjykata merr në konsideratë edhe faktin, që pavarësisht se cilit prind i besohet fëmija për rritje dhe edukim, të dy prindërit kanë të njëjtin detyrim për të kontribuar për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës.

Në caktimin e vlerës si kontribut ushqimor, gjykata duhet të marrë në konsideratë krahas gjendjes ekonomike të prindit kujdestar, edhe nevojat më themelore dhe jetike të prindit debitor, si dhe moshën dhe nevojat materiale të fëmijës për mirërritje dhe edukim.

Kërkimi i detyrimit ushqimor në një masë të caktuar nga prindi kujdestar është i lidhur me shpenzimet e rritjes së fëmijës, moshën, arsimin, nevojat shëndetësore, etj. Siç është përmendur edhe më sipër, Gjykata e ka bazuar vendimmarrjen e saj edhe në nivelin e jetesës të fëmijës gjatë kohës që ai/ajo qëndronte me të dy prindërit.

Për sa më lart, në kushtet kur legjislacioni ynë familjar nuk e parashikon një vlerë monetare të kontributit për pension ushqimor apo detyrimin për ushqim, si për sa i

përket përcaktimit të një kufiri minimal, ashtu dhe atij maksimal, gjykata në përcaktimin e masës së detyrimit ushqimor udhëhiqet nga:

- interesi më i lartë i fëmijës;
- konceptimi i detyrimit për ushqim, si një institut i të drejtës familjare dhe një masë mbrojtëse në interes të fëmijës;
- parimi i proporcionalitetit me standardin e jetesës të vendit ku jeton fëmija;
- minimumi jetikë i të ardhurave në atë rreth, qytet, fshat.

Gjithashtu, bazuar në Axfendën e OKB-së, konkretisht në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm një vëmendje e vecantë iu është dhënë individëve dhe familjeve të varfëra.

Ndërkohë, në analizën që i bëhet legjisllacionit të brendshëm, konstatojmë, se minimumi jetik⁵⁹ dhe përshtatja e tij në planin kohor, e rregulluar me akte nënligjore mungon. Pikërisht ky boshllëk ligjor përbën një standard të munguar në mbrojtjen e të drejtave të individëve, veçanërisht të fëmijëve dhe familjeve në nevojë.

Nga monitorimi është vërejtur, se nuk mungojnë rastet kur vendimi për caktimin e masës së detyrimit ushqimor është marrë edhe në mungesë të prindit, të cilit nuk i është lënë fëmija në kujdestari. Gjykata këtë veprim të prindit debitor e ka cilësuar si mungesë bashkëpunimi, kur është bërë më qëllim apo ka patur arsye për të besuar se është bërë me qëllim për të mos kontribuar financiarisht për fëmijën.

Gjithmonë në raste të tilla, gjykata ka lënë të hapur mundësinë, që në rast të ndryshimit të rrethanave konkrete, kjo do të ketë ndikim edhe në ndryshimin e vendimmarrjes së gjykatës për caktimin e pensionit ushqimor për fëmijën.

Janë konstatuar edhe raste, sidomos në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vlera e pensionit ushqimor është caktuar pa prova të mjaftueshme. Në raste të tilla, gjykata

⁵⁹ Minimumi jetik është indikator social kryesor, i cili përdoret për vlerësimin e varfërisë dhe cilësisë së jetës, si dhe për llogaritjen e pagave minimale, pensioneve minimale dhe pagesave sociale bazë. Niveli i minimumit jetik në vend njihet si shuma e parave që duhet të zotërojë çdo person për të përballuar nevojat bazë të mbijetesës së tij si qenie njerëzore (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, cituar nga ACER, 2016, fq.13).

Minimumi jetik përkufizohet si niveli i të ardhurave i cili garanton që konsumi të përmbushë kërkesat e minimumit të qenieve njerëzore fizike dhe sociale (Avokati i Popullit, 2015, fq. 8-10)

Vlera e minimumit jetik për vitin 2019 në Shqipëri është përafërsisht **17, 875 Leke**. Vlera e përlllogaritur është përcaktuar mbi bazën e një studim për minimumin jetik në Shqipëri, realizuar nga Avokati i Popullit Për më shumë shih “Raport për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri, 2020”

duhet të investohet më shumë në gjetjen dhe verifikimin e kushteve dhe mundësive financiare të prindit debitor.

3. Analiza të rasteve konkrete, realizuar nga institucioni i Avokatit të Popullit

Në zbatim të dispozitave kushtetuese⁶⁰ dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, parashikohen kompetencat e institucionit të AP në tërësi dhe, në veçanti, edhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nga veprimet dhe mosveprimet e organeve të administratës publike ka qënë pjesë e pandashme e veprimtarisë së AP, por përmirësimet ligjore parashikuan për herë të parë në 2014, funksionin e Komisionerit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijës dhe të një strukture të veçantë, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijës⁶¹. Gjithashtu, ligji nr.18/2017⁶², i ngarkon institucionit të AP-së funksionin e veçantë monitorues në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përmirësimet ligjore, ngritja dhe funksionimi i strukturave përkatëse pranë institucionit të Avokatit të Popullit rritën eficensën në drejtim të përmbushjes së funksioneve të AP në fushën e të drejtave të fëmijës në katër funksione kryesore: atë të **mbrojtjes, promovimit, garantimit dhe monitorimit** të të drejtave të fëmijëve në përputhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe legjislacionin e brendshëm. Gjatë kësaj periudhe nga Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara, janë trajtuar rreth **18 raste, ankesa, kërkesa, raste me iniciativë, me objekt ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të pensionit ushqimor**. Institucioni i AP me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi maksimale është përpjekur të sjellë në vëmendje të autoriteteve shtetërore dhe opinionit publik, se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për pensionin ushqimor është element thelbësor i shtetit të së drejtës parë kjo dhe në aspektin e parandalimit të kategorizimit të këtyre fëmijëve si fëmijë në nevojë.

Në këtë pjesë të raportit prezantohet një sintezë e përpjekjeve të vazhdueshme ndër vite, e institucionit të AP për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, të cilat kanë kaluar nëpër një procedurë divorci të prindërve të tyre. Zgjidhja e martesës

⁶⁰ Neni 60 (2) i Kushtetutës: “Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij”.

⁶¹ Neni 31 (4) i ligjit nr.8454 date 4.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, të ndryshuar

⁶² Neni 34 (7) të ligjit 18/2017 «Për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës» parashikon që Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për Avokatin e Popullit

nuk është një ngjarje kalimtare për një fëmijë, por është një proces që zgjat për shumë vite dhe në mjaft raste, ka një impakt jo të mirë në sjelljen e fëmijëve.

Në vendin tonë, në shumicën e vendimmarrjeve për caktimin e prindit kujdestar, gjykata është shprehur për kujdestarinë e nënës. Kushtet edhe situata ekonomike në Shqipëri nuk është aspak favorizuese për nënat e divorcuara dhe fëmijët. Praktikisht, të ardhurat e prindit kujdestar dhe fëmijës pas divorcit gati përgjysmohen. Fakt ky, që në shumë raste, ka ndikuar në kufizimin e të mirave materiale të nevojshme për mirërritjen dhe edukimin e fëmijës. Kjo, rrit mundësinë, që fëmijët të shfaqin sjellje antisociale, të shfaqin probleme të sjelljes në grup, simptoma emocionale, të bëhen pre e abuzimit dhe të braktisin shkollën.

Institucioni i AP, në çdo angazhim të tij ka vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës bazuar në të drejtat e tij për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme.

Në këtë këndvështrim konstatohet, se problematikë kryesore në realizimin e të drejtave të fëmijës, vazhdon të mbetet *shkelja e të drejtës për mbrojtjen e fëmijës* nga të gjithë aktorët për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimi i një jetese të shëndetshme e pa privime si rrjedhojë e gjetjeve në vijim:

- përcaktimi i masës së pensionit ushqimor në vendimet e gjykatës nuk siguron një nivel jetese të mjaftueshme për zhvillimin e tij;
- mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore si rrjedhojë e shumë faktorëve siç është emigrimi, ushtrimi i veprimtarisë private në kushte informale nga ana e prindit, duke shmangur pagimin e tatimeve dhe taksave etj;
- procedurat për marrjen e shërbimeve përmbare janë me afate të gjata kohore dhe ka raste jo efçente (cdo 6 muaj);
- mungesa e të dhënave vjetore statistikore të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Përmbare, mbi situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimit ushqimor, në përgjithësi⁶³.

⁶³ Në kërkesën për informacion drejtuar INSTAT nga Avokati i Popullit lidhur me numrin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimit ushqimor konstatohet, se kjo e dhënë mungon. Të dhënat e vetme që INSTAT na vuri në dispozicion lidhen vetëm me numrin e martesave dhe zgjidhjeve të tyre, dhe këto deri në vitin 2019. Gjithashtu, në vlerësim të të dhënave vjetore statistikore të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Përmbare, mbi situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimit ushqimor, në përgjithësi, si dhe atij ndërkufitar në veçanti kemi konstatuar mungesën e tyre.

Për sa më sipër, institucioni i AP, në kuadër të marrëveshjes së bashkpunimit të nënshkruar me INSTAT me qëllim përditësimin e treguesëve në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), lidhur me të drejtat e njeriut (ku përfshihen dhe të drejtat e fëmijëve) kanë identifikuar treguesit përkatës që mungojnë duke kërkuar përfshirjen e tyre nga ana e këtij institucioni. Avokati i Popullit do të ndjekë me përparësi realizimin e këtij objekti për t'i ardhur në ndihmë politikëbërësve në ngritjen e një regjistri të posaçëm elektronik për menaxhimin e të dhënave të çështjeve përmbartimore lidhur detyrimin ushqimor dhe harmonizimin e tyre me sistemin e gjykatave, për të bërë të mundur monitorimin efektiv të zbatimit të këtyre vendimeve (veçanërisht në rastet kur prindi debitor ndodhet jashtë territorit të vendit).

3.1. Kuadri Ligjor

Procesi i rregullt ligjor, i sanksionuar nga Kushtetuta⁶⁴, konsiderohet si një prej parimeve bazë të shtetit të së drejtës dhe konsiston në dy aspekte kryesore:

- **së pari**, lidhet me mbrojtjen e të drejtave të shtetasve dhe,
- **së dyti**, lidhet me detyrimin e organeve të pushtetit publik, për t'i respektuar këto të drejta duke përmbushur procedurat ligjore.

Paanshmëria dhe pavarësia nga pushtetet e tjera, konkretisht ai Ekzekutivi dhe Legjislativi, janë garanci për një sistem gjyqësor të konsoliduar. Roli i gjyqtarëve dhe gjykatave në një shtet të së drejtës është që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Për këtë arsye, funksionimi normal i gjykatave në shkallë vendi është një domosdoshmëri dhe detyrë funksionale e shtetit, për t'u siguruar qytetarëve një sistem gjyqësor që përmbush këto garanci.

E drejta për një proces të rregullt ligjor garanton të drejtën e çdo personi, që për mbrojtjen e interesave të ligjshme t'i drejtohet gjykatës ose organeve kompetente shtetërore. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesa më kryesore dhe më e rëndësishme e realizimit të së drejtës në një shtet ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të funksionojë, nëse vetë ndërtuesit e tij nuk garantojnë përfitimin material të kësaj të drejte dhe mbrojtjen efektive të saj.

⁶⁴ Shih neni 42

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë realizohet nga Zyra e Shërbimeve Përmbartimore. Një vendim i gjykatës së shkallës së parë quhet i formës “së prerë”, kur kundër tij nuk është bërë apelim brenda afateve ligjore, ndërsa vendimet e Gjykatës së Apelit quhen të formës së prerë për efekt të ekzekutimit, edhe nëse kundër tyre bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të titujve ekzekutive nga Zyra e Përmbartimit janë të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile⁶⁵. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave për detyrimet ushqimore prindërore për fëmijët, rregullohen nga KF dhe KPrC, të cilat kanë përcaktuar disa garanci.

3.2. Faktorët që ndikojnë në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatës për pagesën e kontributit ushqimor për fëmijët është bërë një monitorim jo i plotë, pasi ka mungesë të të dhënave statistikore. Në vjetarin statistikor, që botohet çdo vit nga Ministria e Drejtësisë, nuk gjendet ndonjë e dhënë konkrete, prandaj nuk mund të paraqiten konkluzione për këtë çështje.

Gjithashtu, është e pamundur që të sigurohet ndonjë statistikë, nga Drejtoria e Shërbimit Përmbartimor Shtetëror, si dhe nga Dhoma e Përmbartuesve Privatë. Praktikisht, në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore janë dy alternativa zgjedhjeje, pasi ka dy struktura përmbartimore, shtetërore dhe private. Në këto kushte, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore bëhet edhe më e vështirë.

E vetmja mundësi për të përpunuar informacionin statistikor janë disa të dhëna zyrtare të tërthorta, që mund të mblidhen nga ankesat e bëra pranë institucionit të AP me objekt “Dhënien e detyrimit ushqimor ndaj fëmijës”, nga kallëzimet me objekt “Pengim të ekzekutimit të vendimit të gjykatës”, të bëra për prindin debitor pranë prokurorive të rretheve gjyqësore dhe nga organizatat jofitimprurëse.

Ky raport synon të paraqesë gjendjen e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Numri i ankesave të qytetarëve, drejtuar institucionit të AP për të ndërhyrë pranë autoriteteve përgjegjëse, për të realizuar të drejtën e tyre të fituar gjyqësisht, vazhdon të rritet. Rreth 60% e vendimeve gjyqësore për pagesën e pensionit ushqimor kanë probleme me ekzekutimin për shkaqe nga më të ndryshmet si:

⁶⁵ Respektivisht nenet 510 – 617

- prindi debitor nuk është i punësuar dhe nuk ka pasuri apo prona;
- prindi debitor është i punësuar në punë informale dhe nuk deklaron të ardhura;
- prindi debitor ka prona ose është i punësuar, por zyra e përmbartimit shtetëror nuk ekzekuton vendimin, për shkaqe që nuk shprehen;
- prindi debitor është emigrant dhe nuk është realizuar ende zbatimi i vendimit nga organet kompetente shtetërore;
- prindi debitor është duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë në burg;
- organet shtetërore kanë vepruar me ndërprerje në vjeljen e detyrimeve, ose nëna është vonuar në paraqitjen e kërkesave.

Pranë Institucionit të AP janë bërë kërkesa/ankesa të shumta nga qytetarët, lidhur me problematikat që lidhen me caktimin e masës të pensionit ushqimor dhe me ekzekutimin e vendimeve të gjykatës. Kërkesa/ankesa këto të cilat janë vlerësuar me seriozitetin e duhur nga ky Institucion. AP ka rekomanduar dhe është përpjekur të pasqyrojë në vijimësi mangësitë, shkaqet dhe faktorët që kanë çuar në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me objekt detyrimin e prindit debitor për të paguar pensionin ushqimor për fëmijën.

3.3. Faktorët ekonomikë

Nga monitorimi ka rezultuar se në pjesën më të madhe të rasteve, të analizuara nga institucioni i AP, vendimet nuk janë ekzekutuar për shkak të gjendjes së papunësisë të debitorit ose për shkak të punës informale. Fakt ky, që të çon në përfundimin, se një nga faktorët kryesorë pengues, është **pafuqia ekonomike për shkak të papunësisë**. Kur flasim për faktorë ekonomikë, ekziston qasja, se nuk mund të pritët një zgjidhje e menjëhershme, por një zgjidhje në proces, që lidhet me kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit.

Kjo frymë buron edhe nga Kushtetuta e RSH, e cila punësimin e të gjithë personave të aftë për punë e ka konsideruar një objektiv social⁶⁶ dhe, në të njëjtën kohë, ka vendosur që përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë⁶⁷. Në thelb, kjo situatë nuk mund të trajtohet nga institucionet shtetërore si një pritje e gjatë, pasi duhet të ndërmerren masa pozitive, me qëllim që ky target grup të ketë mundësi të përmbushë detyrimin.

⁶⁶ Shih neni 59 pika 1/a, i Kushtetutës

⁶⁷ Shih neni 59 pika 2, i Kushtetutës

Deri më sot, është synuar zgjidhja përmes pagesave të ndihmës sociale, e cila është parashikuar në aktet ligjore e nënligjore, në një shumë fare të pamjaftueshme⁶⁸. Masa të tjera ekonomike positive mungojnë. Ndërkohë, mund të ishte menduar nga strukturat shtetërore për politika të posaçme punësimi të këtyre personave, me qëllim vjeljen e detyrimit për ushqim për fëmijët, ose politika kompensimi, ku shteti bëhet garant për detyrimin për ushqim ndaj fëmijës, kurse prindi detyrohet ta shlyejë atë në raport me shtetin, në një periudhë të mëvonshme. Gjykojmë, se masa të tilla nga shteti duhet të merren edhe në rastet, kur prindi i detyruar për pagesën është duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë.

Faktor tjetër pengues për mospërmbushjen e detyrimit për ushqim, është edhe **puna informale** e prindit debitor. Në këto kushte, prindi debitor nuk paguan sigurime, nuk e kalon pagën përmes sistemit bankar, nuk deklaron të ardhura dhe për rrjedhojë, nuk mund të detyrohet nga organet kompetente që të paguajë në mënyrë të detyrueshme pensionin ushqimor. Kjo çështje nuk duhet vlerësuar thjesht si një problem që vjen për shkak të moszhvillimit ekonomik, por edhe për shkak të mosfunksionimit institucional dhe të mosefektivitetit të tyre për zbatimin e legjislacionit.

Mosmarrja e masave të nevojshme për reduktimin e informalitetit në ekonomi, bëhet **shkak për një proces të parregullt ligjor në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore** me objekt “Detyrimin për të paguar pension ushqimor ndaj fëmijës”.

3.4. Emigrimi

Në disa raste të ndjekura nga AP, prindi debitor jeton jashtë shtetit si emigrant. Këto raste, për nga kompleksiteti paraqiten në praktikë si krejt të pashpresa. Ato nuk ekzekutohen për një kohë të gjatë ose, asnjëherë.

Në fakt, aktet ndërkombëtare sanksionojnë të drejtën e vjeljes së detyrimit për ushqim, edhe kur prindërit janë jashtë shtetit. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme në mënyrë që të sigurojnë marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare për fëmijën, qoftë brenda ose jashtë vendit⁶⁹.

⁶⁸ Ligji nr.9355 datë 10.3.2005 - ndryshuar me ligjin nr. 9602 datë 28.07.2006; ligjin nr. 10252 date 11.03.2010; ligjin nr.10 399 datë 17.3.2011; ligjin nr.25/2013; ligjin nr. 47/2014; ligjin nr.44/2016.

⁶⁹ Shih neni 27/4 të KDF

Shteti Shqiptar ka aderuar në konventa ndërkombëtare, si dhe ka ratifikuar Konventën e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”. Mbi bazën e kësaj Konvente, Shteti Shqiptar mund të ekzekutojë vendimin e një gjykate shqiptare për detyrimin ushqimor, në një shtet tjetër. Megjithatë, mund të thuhet paraprakisht se mekanizmat garantues institucionalë janë krejt të pafuqishëm. Nga të dhënat zyrtare nuk jemi në gjendje të evidentojmë, nëse ka pasur ndonjë rast të vetëm apo jo, kur shteti shqiptar ka ekzekutuar detyrimin ushqimor në bazë të këtyre konventave ndërkombëtare.

3.5. Faktorët institucionalë

Institucioni i AP ka konstatuar se një faktor i dukshëm pengues për ekzekutimin e vendimeve lidhur me detyrimin ushqimor për fëmijët, është edhe **mungesa e theksuar e efektivitetit institucional**. Kjo dobësi shfaqet qartë, si në rastet kur prindi debitor është i punësuar ose ka prona, por shërbimi përmbarimor shtetëror nuk ekzekuton në kohë vendimin, ashtu edhe në rastin kur prindi debitor është emigrant.

Në këtë kuadër, problemet e zbatimit të vendimeve fillojnë nga mangësitë e vetë zyrës së shërbimit përmbarimor. Nga monitorimi i kryer, në disa raste, ka rezultuar se detyrimet për ushqim nuk janë ekzekutuar, edhe pse prindi debitor nuk paraqet asnjë pretendim të ligjshëm, por justifikohet se ka krijuar familje tjetër, ose nuk janë të sigurt për atësinë, ose nuk kanë adresë, apo i shmangen qëllimisht paraqitjes përpara përmbaruesit.

KF përcakton si datë të fillimit të detyrimit për ushqim, datën e ngritjes së padisë⁷⁰. Por, fakti që Kodi nuk vendos që vendimi i gjykatës për caktimin e detyrimit ushqimor të jetë automatikisht titull ekzekutiv, ka sjellë probleme për ekzekutimin e tij në praktikë.

Por nga ana tjetër, kjo mungesë parashikimi e KF mund të evitohet nga aplikimi i nenit 317 I K.Pr.Civile i cili citon rastet e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm. Konkretisht në pikën a të këtij neni është parashikuar se vendimi i gjykatës për detyrimin për ushqim mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, parashikim ky që i jep menjëherë efekte zbatuese dispozitivit të gjykatës mbi aplikimin e detyrimit ushqimor.

Gjykatat i kanë të gjitha mundësit ligjore duke u nisur edhe nga natyra shumë specifike e këtyre konflikteve gjyqësore, që të aplikojnë dhënien e këtyre vendimeve me ekzekutim të përkohshëm. Kjo do të eliminonte të gjitha zvarritjet që do të sillte

⁷⁰ Shih neni 210 i KF

ankimimi në themel i vendimi për zgjidhje martese dhe pasojave që rrjedhin prej saj. Gjykata nuk duhet të kufizohet për aplikimin e këtij parashikimi ligjor të nenit 317/a I K.Pr.Civile nga fakti nëse është kërkuar apo jo nga palët ndërgjyqëse por duhet ta zbatoj me iniciativën e saj në mbrojtje të interes më të lartë të fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës çenohet nga vonesa në zbatim i së drejtës së tij për të gëzuar pensionin ushqimor pavarësisht shkaktimit të saj nga shkaqe objektive apo subjektive.

Problematikat e tjera i referohen procedurës për vënie në ekzekutim të këtij vendimi , pra një faze të mëvonshme që lidhet me subjektin që e ushtron këtë të drejtë si dhe me afatin se kur duhet të vihet në ekzekutim nga momenti që vendim ka marrë formë të prerë.

Fakti që kërkesën për ta vënë në ekzekutim duhet ta bëjë prindi kujdestar, do të thotë se vendimi i gjykatës mund të vihet në ekzekutim, vetëm nga prindi që mban fëmijën për rritje dhe edukim dhe që ka nevojë për mbështetje ekonomike.

Një përcaktim tjetër në KF është, se nëse vënia në ekzekutim e vendimit që përmban detyrimin për ushqim, kryhet pas 6 muajve nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, detyrimet për ushqim janë të kërkueshme për 6 muajt e fundit⁷¹. Nga praktika është konstatuar se ky fakt, ka sjellë pjesëzime të mëdha në përmbushjen e detyrimeve. Për arsye të ndryshme, prindërit debitorë e shtyjnë ekzekutimin e pagesave të pensionit ushqimor ose e bëjnë ekzekutimin me vonesë.

Kjo ndodh për shkak se, palët nuk i njohin të drejtat dhe kufizimet e parashikuara në ligj. Gjithashtu, prindi kujdestar në mjaft raste, heziton të vërë në ekzekutim vendimin, pasi shpreson në një ekzekutim vullnetar të prindit tjetër. Në situata të tilla edhe shërbimi përmbartimor ka një rol negativ, pasi e shtyjnë procesin e ekzekutimit të pensionit ushqimor me arsyetime si kanë volum të madh pune, ose ekzekutimi është për shumën të vogla që nuk kanë pse të investohen, ose prindi debitor nuk ka të ardhura apo pasuri, ose nuk i gjejnë dot pasuri prindit debitor, etj.

Kjo situatë ka sjellë si pasojë, një numër në rritje të rasteve, që prindërit kujdestarë e vënë në ekzekutim vendimin e gjykatës tej afateve ligjore. Në këto kushte, duket qartë mangësia që krijohet për shkak të mungesës së njohurive mbi legjislacionin.

Problematika e referuar më lart mund të evitohet plotësisht në rast se do të bëheshin disa parashikime më specifike në K.F të ndërthurura këto me dispozitat të natyrës procedurale. Konkretisht të parashikohet e drejta e gjykatës për të marrë që në veprimet paraprake një vendim për caktim të detyrimit ushqimor, vendim I cili do të

⁷¹ Ahih neni 211 i KF

vihej menjëherë në ekzekutim. Në këtë mënyrë cdo faktor që do të sillte zvarritjen e procesit gjyqësor, nuk do të kishte ndikim negative në aplikimin efektiv të interesit më të lartë të fëmijës. Kjo ndërhyrje procedurale është e nevojshme për të evituar një numër të madh problematikash që ka sot gjyqësori si nga pikpamja e ngarkesës ashtu edhe nga faktor të tjerë që ndikojnë tek dhënia e një drejtësie të vonuar.

Në kuadrin e faktorëve institucionalë, garancitë që duhet të ofrohen nga zyrat përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve për pagesat e pensionit ushqimor për fëmijët janë padyshim një faktor i rëndësishëm. Mospasja e të dhënave të plotë statistikore na pengon për bërjen e një analize të plotë të punës së shërbimit përmbarimor shtetëror. Duke qenë se, këtë shërbim e vënë në lëvizje kryesisht kategori, që nuk kanë mundësi financiare, ka arsye për të thënë se ka nevojë për përmirësime.

Në vendin tonë, i parashikuar në ligj, si person juridik publik, në varësinë e ministrit të Drejtësisë, është edhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas⁷², e cila duhet të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, që lidhen me ekzekutimin e vendimeve për pagesën e pensionit ushqimor për fëmijët.

Praktikisht, ndihma ligjore falas e ofruar nga kjo strukturë nuk garanton ashtu si duhet grupet në nevojë apo në pamundësi familjare, që i drejtohen gjykatës për paditë me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, ndër të cilat edhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët.

4. Përfundime dhe Rekomandime

Nga monitorimi i bërë është vërejtur, se gjykatat e rretheve gjyqësore, në Tiranë dhe në nivel kombëtar, si dhe Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimet e tyre u janë referuar si Konventave Ndërkombëtare ashtu dhe praktikës së GJEDNJ, që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe me parimin e interesit më të lartë të tyre. Pozitiv është fakti, që gjyqtarët kanë krijuar një standard procedural duke ju referuar konventave mbi të drejtat e fëmijëve, të ratifikuara nga shteti shqiptar. Megjithatë, referenca e tyre në këto akte ndërkombëtare, është e lidhur *vetëm me parimet e përgjegjësisë prindërore dhe me procedurat e lënies të fëmijëve për rritje dhe edukim njërit prind.*

⁷² Ligji nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 8.

Nuk rezulton të jetë argumentuar referimi në këto akte ndërkombëtare, lidhur me të drejtën parësore të fëmijës për të përfituar detyrimin ushqimor ndaj prindit debitor, në raport me nevojat jetësore për mirërritje, zhvillim, mirëqënie, edukim dhe arsimim. Pra, referimi në aktet ndërkombëtare dhe praktikën e GJEDNJ, ose mekanizmave të tjerë ndërkombëtare bëhet vetëm në lidhje me lënien e fëmijës për rritje dhe edukim një prindi dhe të drejtën e takimit për prindin tjetër dhe nuk përbën një referim përmbajtësor për të përqaftuar standardin më të mirë të aplikuar në vendet e Këshillit të Evropës.

Element mjaft i rëndësishëm që është i lidhur ngushtë me interesin më të lartë të fëmijës është edhe caktimi i detyrimit ushqimor. Në këtë kuptim, **gjyqtarët duhet t'u referohen akteve ndërkombëtare**, pasi në to paraqiten disa kritere, mbi mënyrën e vlerësimit dhe caktimit të pensionit ushqimor për fëmijën. Kritere këto, në funksion të fëmijës që t'i krijohen mundësi për të pasur cilësi dhe standardin më të mirë të mundshëm, edhe pse prindërit janë të divorcuar dhe mund të mos kenë një raport të mirë mes tyre.

Gjykata në çdo rast, **duhet të investohet fort për të vlerësuar mundësitë reale financiare të prindit debitor**, me qëllim që fëmijës t'i ofrohet një cilësi dhe standard jetese i mirë dhe jo i ndryshëm nga i mëparshmi.

Legjislacioni ynë familjar nuk parashikon një vlerë monetare të kontributit për pension ushqimor apo detyrimin për ushqim, si për sa i përket përcaktimit të një kufiri minimal, ashtu dhe atij maksimal. Detyrimi për ushqim është një detyrim jashtëkontraktor. Si i tillë, ai është i papërcaktuar nga vullneti i palëve, prandaj kuptimi dhe gama e llojeve të shpenzimeve që do të merren parasysht në llogaritjen e tij duhet të burojnë nga interpretimi i ligjit.

Në këto kushte, sugjerohet, që **detyrimi për ushqim për fëmijën duhet të përfshijë gjithçka që është e domosdoshme** për të plotësuar nevojat materiale dhe kulturore të jetesës së fëmijës dhe më konkretisht, duhet të përfshijë **shpenzimet për ushqimin, veshmbathjen, banimin, ngrohjen, shërbimin mjekësor, edukimin, argëtimin dhe çdo veprimtari tjetër të domosdoshme** për një jetë normale. Këto në asnjë rast nuk duhet të konsiderohen nga gjykata si shpenzime të tepërta.

Gjykata gjithmonë shprehet me arsyetimin, se në caktimin e vlerës të pensionit ushqimor, apo masës së detyrimit ushqimor ka marrë në konsideratë, jo vetëm nevojat që duhet t'i plotësohen fëmijës, por edhe “mundësitë ekonomike” të prindit të detyruar për të paguar pensionin ushqimor. Në shumë raste, gjykimi ka rezultuar në një vendimmarrje të bazuar në fakte dhe prova.

Gjykata në përcaktimin real të mundësive ekonomike të prindit nuk duhet të bazohet vetëm në të ardhurat e secilit prind, por edhe në të ardhurat që burojnë nga pasuria e secilit prind. Prandaj gjykata duhet të jetë e angazhuar në marrjen e informacionit nga institucione të ndryshme si Agjencia Shtetërore e Kadastrës⁷³, Zyrat e Tatimeve apo institucioneve të tjera pranë të cilave mund të sigurohen të dhëna mbi gjendjen pasurore të prindit tjetër.

Janë vërejtur edhe raste, kur ky përcaktim ka rezultuar i mangët si pasojë e “pamundësisë apo/dhe paaftësisë objektive” të prindit debitor, i cili nuk ka paraqitur dokumentacion financiar të plotë. Gjykata në këto raste nuk ka insistuar që ta ngarkojë prindin debitor “neglizhent” me detyrimin për të plotësuar dokumentacionin e të ardhurave financiare. Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të bëhet duke u trajtuar ky interesdrejtpërdrejt dhe posaçërisht nga gjykata .

Në çdo vendimmarrje për caktimin e vlerës të pensionit ushqimor, gjykata duhet të paraqesë një nivel bazë të të ardhurave që duhet të ketë një fëmijë apo familje me qëllim që të mbijetojë me dinjitet, në një shoqëri ku pretendojmë që shanset janë të barabarta.

Në legjislacionin aktual shqiptar mungon një dispozitë e posaçme kushtuar minimumit jetik si për përkufizimin ligjor të tij, ashtu dhe për detyrimin ligjor për llogaritjen e tij⁷⁴. Bazuar në interesin parësor të fëmijës, **gjykata në vendimmarrjen e saj duhet të marrë në konsideratë edhe minimumin jetik, si një vlerë e cila duhet t’i referohet shumës së shpenzimeve mujore që shpenzon një individ dhe familja e tij.** Termi minimum jetik mund të citohet në arsyetimet e gjykatës, por praktikisht nuk jepet asnjë interpretim i qartë për ta zhvilluar si terminologji dhe më tej si një funksion.

Në çdo rast, gjykata duhet ta bazojë vendimmarrjen e saj edhe në **nivelin e jetesës të fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit.**

⁷³ Ligji nr.111/2018 “Për Kadastrat” botuar në Fletoren Zyrtare nr.28 datë 07.02.2019, që shfuqizon Ligjin nr.33/2012 datë 21.03.2012 “Për rregjistrimin e Pasurisë të Paluajtëshme”, I ndryshuar.

⁷⁴ Për të nxjerrë se sa është minimumi jetik në Shqipëri, është bërë një përpjekje e vazhdueshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Për më shumë shih “Raport për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri, 2020”

Ndaj, sugjerohet, që togfjalëshi “*mundësitë ekonomike*”⁷⁵ të personit të detyruar të nënkuptojë **marrjen parasysh të çdo lloj zotërimi apo posedimi të prindit debitor**, të tilla si: pasuritë, ku përfshihen aktivet e pasurisë së personit dhe debitë e tij, me qëllim që të përcaktohen mundësitë reale që ka personi i detyruar për të përmbushur detyrimin për ushqim. Pra, **gjyqtari duhet t’i përcaktojë mundësitë ekonomike të të detyruarit, në mënyrë më gjithëpërfshirëse.**

Caktimi i vlerës të pensionit ushqimor duhet të bëhet duke marrë parasysh, si të ardhurat që vijnë kryesisht nga paga dhe çdo shpërblim tjetër me karakter të përhershëm, ashtu dhe në përcaktimin e “*mundësive*” financiare. Pra, duhet të bëhet një vlerësim në harmoni, mes të ardhurave dhe shpenzimeve të prindit të detyruar për të paguar pension ushqimor. “*Mundësi*” nënkupton, shumën që i detyruari mund t’i japë përfituesit në varësi të të ardhurave që i mbeten pas zbritjes së shpenzimeve, të cilat ai detyrohet të realizojë në përmbushje të kërkesave për jetesë apo për personat e tjerë të familjes së tij.

Në kuadër të nevojës financiare, gjykata duhet t’i japë përparësi plotësimi të nevojave ekonomike dhe kushteve të jetesës të fëmijës dhe jo të bazohet vetëm në arsyetime standarde. Gjkata në caktimin e masës së detyrimit për ushqim merr për bazë nevojat e fëmijëve, si dhe burimet dhe mundësitë ekonomike dhe financiare të të dy palëve ndërgjyqëse.

Gjkata i kushton një rëndësi të veçantë, pjesës së arsyetimit të vendimit që lidhet me lënien e fëmijës në rritje dhe edukim të njërit prind, por nuk i kushton dhe aq vëmendje lidhjes midis caktimit të masës së detyrimit ushqimor dhe interesit më të lartë të fëmijës. Madje, nuk mungojnë rastet kur vendimi për caktimin e masës së detyrimit ushqimor merret në mungesë të palës së paditur dhe pa patur prova të mjaftueshme për të caktuar masën e këtij detyrimi.

Kontributi material është i një rëndësie parësore për mirërritjen e fëmijës, ndaj ligjvënësi ka konsideruar që përcaktimi i tij nuk mund ti lihet ekskluzivisht vlerësimit të prindërve të fëmijës. Prandaj gjykata nuk duhet të marrë në konsideratë pretendimet e palëve për të caktuar detyrimin ushqimor të prindit/bashkëshortit tjetër për fëmijën. Gjkata e cakton masën e detyrimit ushqimor, duke mbajtur parasysh detyrimin për të plotësuar nevojat jetike për fëmijën, pavarësisht kërkesave të palëve. Edhe në rastet kur prindi, të cilit i lihet fëmija për rritje dhe edukim merr përsipër të përmbushë i vetëm kontributin material për fëmijët, gjykata duhet të çmojë nëse kjo është në pajtim me interesin më të lartë të fëmijës.

⁷⁵ Shih neni 201 i KF

Gjykata para se të vendosë nën kujdestarinë e cilit prind do të jetë fëmija, vlerëson me përparësi dhe në mënyrë të veçantë:

- shkallën e afeksionit dhe kujdesin e vazhdueshëm që të dy bashkëshortët kanë treguar për rritjen e fëmijës të tyre;
- kushtet e jetesës të ish – bashkëshortëve, si dhe situatën financiare të secilit nëse ata mund t’i garantojnë fëmijës së tyre një zhvillim të shëndoshë moral dhe fizik;
- raportin psikologjik, që paraqet një panoramë të nevojave emocionale të fëmijës;
- sjelljen e ish – bashkëshortëve gjatë procesit gjyqësor, nëse është korrekte dhe bashkëpunuese.

Në këtë kontekst, sugjerohet, që gjykata duhet t’i kushtojë të njëjtën vëmendje **lidhjes midis caktimit të masës së detyrimit ushqimor dhe interesit më të lartë të fëmijës**. Praktika gjyqësore ka vlerësuar, se detyrimi për ushqim i fëmijës ka të bëjë me mirëqenien materiale të fëmijëve, pra ai është detyrimi thelbësor që rrjedh nga përgjegjësia prindërore. Në caktimin e detyrimit për ushqim, gjykata nisat nga interesi më i lartë i fëmijës, por edhe nga burimet dhe kushtet konkrete ekonomike të palëve.

Zgjidhja e martesës sjell ndryshim në të ardhurat familjare për prindërit, si dhe ndikon në cilësinë e jetesës së fëmijës. Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore praktikisht ndahet midis dy prindërve për fëmijën. Në këtë kuptim, meqenëse secili prind ka përgjegjësi ligjore dhe duhet të kujdeset për fëmijën, **gjykata duhet të bazohet në parimin e proporcionalitetit për të caktuar masën për detyrimin ushqimor**. Një element i cili duhet të konsiderohet në këtë vlerësim ka të bëjë edhe me kontributin financiar që kanë pasur më parë në familje bashkëshortët. Ky koncept duhet të zbatohet duke iu kundërvënë prezumimit ligjor të kontributit 50% me 50% në favor të qasjes që fokusohet në kontributin efektiv të prindërve, si dhe mirëqenien dhe/apo standardin konkret të fëmijëve në familjen ligjore apo bashkëjetuese para ndarjes së çiftit.

Nisur nga të dhëna të konfirmuara dhe të parashtruara nga palët në gjykim, gjykata duhet të vlerësojë edhe masën e detyrimit, si të prindit kujdestar, ashtu dhe të prindit debitor, për ushqimin dhe për mirërritjen e fëmijës. Janë evidentuar plot raste, kur të dy prindërit janë të pamundur nga ana ekonomike për të plotësuar individualisht nevojat e fëmijës. Prandaj, gjykata në vendimin e saj duhet të tregohet racionale. Në kushte të tilla, **gjykata duhet ta vendosë masën e detyrimit për ushqim, jo vetëm**

në raport me nevojat e fëmijës, por edhe në raport me mundësitë financiare të prindit në cdo rast jo më pak se minimumi jetik.

Për këtë konstatim, sugjerohet, që gjykata në rastet kur konstaton, se si prindi kujdestar, ashtu dhe prindi debitor, **nuk kanë mundësi financiare për tu përgjigjur individualisht për plotësimin e nevojave bazike të fëmijës, duhet të vendosë për një ndarje të kujdestarisë të fëmijës në mënyrë atipike.**

Gjykata duhet të caktojë ditët konkrete, që secili prind do të ketë kujdestarinë e plotë të fëmijës, si dhe përgjegjësinë financiare të prindit për ato ditë. Në këtë mënyrë, do të ketë dhe një ndarje proporcionale të shpenzimeve për strehim, ushqim, veshmbathje, edukim etj, pasi secili prind do të kujdeset plotësisht për fëmijën në ditët që ai do të ketë kujdestarinë e plotë. Kjo është një mënyrë alternative që do të ndikojë në plotësimin e nevojave të fëmijës, por nuk vë në pozita të vështira edhe prindin i cili mund të ketë vështirësi financiare.

Gjithmonë, kjo mënyrë e ndarjes së kujdestarisë duhet bërë atëherë, kur të dy prindërit janë në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare dhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës. Qëllimi kryesor është, që fëmijës t'i ruhet sa më shumë të jetë e mundur niveli i jetesës që kishte gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit. Gjykata duhet të caktojë një sistem të tillë kujdestarie që **të përfshijë edhe plotësimin e nevojave bazike të fëmijës nga të dy prindërit, pasi detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e fëmijës si përfitues dhe mundësinë e prindit debitor.** Detyrimi për ushqim nuk duhet të kapërcejë atë që është e nevojshme për jetën e fëmijës, duke pasur parasysh edhe rrethanat e jetës së tij në familje para divorcit të prindërve⁷⁶.

Ky model kujdestarie do të bëjë që fëmija të ketë një jetesë materiale të ngjashme me atë që ka patur gjatë bashkëjetesës së prindërve dhe jetesës në një familje, në përputhje me nivelin e jetesës të të dy prindërve të tij.

Për sa më sipër, sugjerohet, që **gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe të ashtuquajturat prova atipike**⁷⁷. Të tilla në procesin civil janë cilësuar dhe

⁷⁶ Shih neni 201/2 i KF

⁷⁷ Në vendimin nr 136 datë 21.03.2017 Gjykata e Lartë ka zhvilluar konceptin e proves atipike, duke orientuar qartazi gjykatat më të ulta në lejimin e marrjes për shqyrtim të tyre, sikurse dhe procedurën për deklarimin e papërdorshmërisë së provës. *“Kolegji vlerëson se çdo lloj prove që nuk është përjashtuar në mënyrë të shprehur nga ligji si e papërdorshme pranohet nga gjykata në gjykimin civil, administrativ dhe penal, kur ka lidhje me objektin e të provuarit. Kolegji vlerëson se përgjithësisht provat atipike, më shumë se prova të paparashikuara dhe të parregulluara nga ligji janë prova që mbartin elementë të përzier dhe të ndërmjetëm të provave tipike. Tipiciteti i mjetit provues ka të bëjë jo*

komunikimet në rrugë elektronike (*e-mail apo mjete të tjera komunikimi elektronik viber apo ehatsApp*), mes vetë palëve të përfshira në konflikt apo mes tyre dhe të tretëve, nga të cilat mund të burojnë fakte të rëndësishme, jo vetëm për raportin juridik mes ish – bashkëshortëve, por edhe për kushtet dhe mundësitë financiare të tyre.

Zhvillimi teknologjik ka nxitur dhe format e reja të komunikimit njerëzor, të cilat duhen reflektuar dhe në mjetet provuese të përdorura nga palët gjatë procesit civil, të ndeshura shpesh herë në konfliktet apo mosmarrëveshjet me natyrë familjare. Komunikimet elektronike edhe pse janë vështirësisht të kategorizueshme në një ndër provat e sanksionuara në KPrC, pasi mbartin tipare të përziera të një regjistrimi në format elektronik apo të një prove shkresore, mund të përdoren në vendimmarrjet e gjykatës.

Gjykata e Lartë ka patur rastin, që gjatë ushtrimit të juridiksionit rishikues të mbajë qëndrime orientuese dhe në raport me këto lloj provash, sikurse rezulton në Vendimin nr.92/2013. *Gjykata e Lartë ka vlerësuar se komunikimet elektronike ndonëse nuk kanë formën tipike të provave të sanksionuara në Kodin e Procedurës Civile duhet të lejohen për shqyrtim nga gjykata dhe nuk mund të anashkalohen për sa kohë që përmbajnë të dhëna të vlefshme për zgjidhjen në themel të konfliktit.*

Në kuadrin e faktorëve institucionalë, garancitë ligjore që ofron Shërbimi Përmbarrimor Shtetëror janë padyshim një faktor i rëndësishëm në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor për fëmijët, brenda afateve të arsyeshme. Ekzekutimi i vendimeve ndikon, jo vetëm në plotësimin e nevojave materiale në interes të fëmijës, por lidhet dhe me respektimin e një të drejte ligjore të dhënë nga gjykata.

Për këtë qëllim, sugjerojmë në vazhdimësi **rritjen e efektivitetit dhe kapacitetit profesional të zyrave të shërbimit përmbarrimor**, lidhur me ekzekutimin e vendimeve për detyrimin ushqimor për fëmijët. Kjo do të sjellë një përmirësim të garancive ligjore për ekzekutimin e vendimeve të kësaj kategorie, brenda një afati të arsyeshëm dhe në vijimësi në interes të fëmijës.

vetëm me formën, por dhe me përmbajtjen, ndërkohë që provat atipike mund të kenë formën e një prove të caktuar, ndërsa në përmbajtje kanë elementë të një prove tjetër.....Kolegji arrin në konkluzionin se provat atipike mund të përdoren në gjykimin civil dhe administrative, dhe për provat atipike do të zbatohen rregullat ligjore të zbatueshme për provat tipike korresponduese, qoftë dhe përmes interpretimit të këtyre normave me analogji...”

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarrimor **duhet të angazhohet për të pasqyruar gjendjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve**. Gjithashtu, ajo duhet të krijojë të gjithë mekanizmat e përshtatshëm për marrjen e informacionit. Çdo qytetar i interesuar ka të drejtë të marrë dijeni për arsyet e mosekzekutimit të pensionit ushqimor për fëmijën.

Ndaj, sugjerojmë një angazhim më gjithëpërfshirës të këtij institucioni. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarrimor **duhet të përpunojë dhe të publikojë të dhëna të sakta** për situatën dhe kushtet e ekzekutimit apo mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve.

Përmbarruesi gjyqësor gëzon cilësinë e subjektit procedural në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Pra, prindi kujdestar ka të drejtë ligjore t'i kërkojë përmbarruesit kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale për ekzekutimin e detyrimit ushqimor për fëmijën. Në mjaft raste, janë konstatuar vonesa, neglizhenca në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të kësaj kategorie.

Për këtë qëllim, sugjerojmë **të rishikohen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve që ngarkohen me ekzekutimin e vendimeve për detyrimin ushqimor**, me qëllim që të krijohen mekanizma sa më efektivë për realizimin në kohë të ekzekutimit. **Duhet që të plotësohet kuadri ligjor i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor me akte nënligjore**, të cilat të kenë sanksione për përmbarruesit që në mënyrë neglizhente ose me dashje nuk kryejnë punën e tyre.

Institucionet përgjegjëse shtetërore, sidomos MD, duhet të angazhohen për të hartuar një strategji konkrete lidhur me pasqyrimin e plotë të gjendjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve, dhe të publikojnë të dhëna të sakta për situatën e zbatimit të tyre. Për këtë është e nevojshme që MD, **të njohë dhe të monitorojë situatën e shërbimit përmbarrimor shtetëror dhe privat**, lidhur me ekzekutimin apo mosekzekutimin vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve.

MD **duhet të angazhohet për hartimin e një manuali shpjegues** në lidhje me procedurat përmbarrimore që duhet të kryhen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijën dhe të sigurojë rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në vazhdimësi për këtë çështje.

Në zbatim të Konventave Ndërkombëtare⁷⁸, shteti Shqiptar mund të ekzekutojë vendimin e një gjykate shqiptare për detyrimin ushqimor, në një shtet tjetër. Megjithatë, nga të dhënat zyrtare nuk evidentohet, nëse ka pasur ndonjë rast, kur shteti shqiptar ka ekzekutuar detyrimin ushqimor për fëmijën, në bazë të këtyre konventave nderkombetare.

Ndaj, sugjerojmë, që MD duhet të ketë në vëmendje të vazhdueshme **krijimin e mundësive për ekzekutimin e vendimeve për detyrimin ushqimor, kur prindi debitor ndodhet jashtë territorit të RSH.**⁷⁹

Një ndër shkaqet kryesore, që ndikon në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor të fëmijës **është papunësia e prindit debitor**. MD në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, **duhet të ndërmmarrë masa serioze për këtë kategori të papunësh.**

Në këtë rast, sugjerojmë, që MD të **ndërmarrë angazhim ligjor për të mundësuar zëvendësimin e prindit debitor nga shteti, për një periudhë emergjente**. Ky trajtim i veçantë duhet të realizohet të paktën për prindërit debitorë që duhet të paguajnë pension ushqimor për fëmijët deri në 14 vjeç. Kjo është një mundësi pozitive jo vetëm në interes të fëmijës, por edhe për prindin debitor. Më pas, shteti ka të drejtë të kërkojë nga prindi debitor të gjithë vlerën e paguar si detyrim ushqimor për fëmijën e tij.

Shteti mund të gjendet para një iniciative të vështirë për t'u realizuar, por jo të pamundur. Ndërkohë, që detyrimi i tij në lidhje me këtë çështje është i parashikuar në Kushtetutë.

Në vijim, sugjerojmë **të rritet roli i gjykatave** për të krijuar një standard të konsoliduar në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt “Caktimin e detyrimit ushqimor në interesin e fëmijës”, me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të individit dhe zbatimin e dispozitave të reja të KPrC sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore (nenet 399/2 e vijues të KPrC). Gjithashtu, me ndryshimet e

⁷⁸ Shih neni 27/4 KDF. Shih Konventën e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (ligj nr. 63/2012).

⁷⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH, Nr. 24, datë 21.4.2014, në eë.gjk.gov.al “Gjykata eidenton faktin se ky organ, edhe pse nuk mund të investohet drejtpërdrejt nga kërkuesja në procesin e nisjes së një procedure për njohje dhe zbatim vendimi gjyqësor në territorin grek, nëpërmjet ekspertizës dhe praktikës që kjo ministri ndjek në zbatim të këtyre konventave, ka pasur të gjitha mundësitë për të orientuar drejt kërkuesen mbi bazën ligjore të përshtatshme, të zbatueshme në këtë rast, si dhe hapat që duhet të ndërmerre për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek...”

reja kushtetuese të vitit 2016, Gjykata Kushtetuese është tashmë një mjet efektiv jo vetëm për shkeljet e procesit të rregullt ligjor, por edhe për shkeljet substanciale të të drejtave dhe lirive themelore të individit, ku përfshihen dhe fëmijët, të garantuara në Kushtetutë.

Në funksion të vlerësimit dhe mbajtjes në konsideratë të interesit më të lartë të fëmijës, bazuar në të drejtat e tij për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme po paraqesim këto rekomandime.

Rekomandohet **përmirësimi i arsytimit nga ana e gjyqtarëve** të gjykatave të rretheve gjyqësore në lidhje me caktimin e masës së detyrimit ushqimor dhe mbështetjen e vendimmarrjes jo vetëm në dispozitat ligjore, por edhe në fakte, rrethana dhe prova.

Rekomandohet **rritja e efektivitetit të gjykimit për caktimin e masës së detyrimit ushqimor për fëmijën** jo vetëm përmes legjislacionit të brendshëm, por kryesisht përmes njohjes së jurisprudencave më të mira në këtë fushë.

Rekomandohet **organizimi i trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës për gjyqtarët**, në lidhje me arsytimin e vendimmarrjeve për caktimin e detyrimit ushqimor dhe respektimin pa kushte të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Rekomandohet **rritja e nivelit të informacionit të qytetarëve, komunitetit mbi të drejtën e tyre për shërbim ligjor falas dhe cilësor, edhe në proceset gjyqësore që mbulohen nga e drejta familjare**. Sidomos për ato procese gjyqësore me objekt **“Caktimin/kërkimin e detyrimit ushqimor për fëmijët”**.⁸⁰

Rekomandohet **përcaktimi në Kodin e Familjes i një kufiri minimal dhe maksimal për caktimin e detyrimit ushqimor**, referuar në pagën minimale, në të ardhurat personale dhe familjare, pasurinë faktike etj.

⁸⁰ Bazuar në korrespondencën e mbajtur ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Drejtorisë të Ndihmës Juridike Falas, është vërejtur se kjo Strukturë është angazhuar, kryesisht, me:

1. Të miturit viktimë të dhunës në familje
2. Të miturit viktimë të abuzimit seksual dhe të miturit viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal
3. Viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal
4. Fëmijët të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore
5. Fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor

Rekomandohet **hartimi i një metodologjie për të ndihmuar gjyqtarët e të gjitha niveleve me qëllim përcaktimin në vlerë monetare të detyrimit ushqimor** duke u bazuar në vlerësime konkrete të çështjeve, rast pas rasti.

Rekomandohet **amendimi i Kodit të Familjes, për të garantuar lëshimin dhe zbatimin automatik të urdhrit të gjykatës si masë paraprake për pensionin ushqimor të fëmijës**, gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit gjyqësor deri në vendimin e formës së prerë të gjykatës.

Rekomandohet **parashikimi në legjislacion i rasteve për kompensimin e detyrimit ushqimor nga Shteti** dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi, midis prindit që detyrohet dhe Shtetit.

Rekomandohet **parashikimi në legjislacion i marrjes së vendimit për caktim të detyrimit ushqimor që në fazën e kryerjes së veprime përgatitore nga ana e Gjykatës me ekzekutim të menjëhershëm**, mënyrë kjo që do të mbrojë në shkallën më të lartë interesin e fëmijës duke evituar çdo problematikë në fazën e ekzekutimit.

Rekomandohet **ngritja e një regjistri të posaçëm elektronik për menaxhimin e të dhënave të çështjeve përmbarimore lidhur detyrimin ushqimor dhe harmonizimi i tij me sistemin e gjykatave**, për të bërë të mundur monitorimin efektiv të zbatimit të këtyre vendimeve (veçanërisht në rastet kur prindi debitor ndodhet jashtë territorit të vendit).

Rekomandohet **përmirësimi i garancive ligjore për ekzekutimin e vendimeve mbi detyrimet ushqimore, brenda një afati të arsyeshëm** dhe në vijimësi duke hequr penaltetet për mosparaqitjen e kërkesës në afatin 6-mujor. Qëllimi i kontributit për ushqim është plotësimi i nevojave reale të kërkuarit sa i përket ushqimit për jetesë, që nga koha e paraqitjes së kërkesës dhe në të ardhmen. Kjo passjell kërkimin e detyrimit ushqimor vetëm për të ardhmen dhe jo për kohën e kaluar. Megjithatë rekomandojmë dhënien e mundësisë fëmijës madhor për të kërkuar detyrimin ushqimor/kompensimin nga prindi i cili, edhe pse ka pasur mundësinë të kontribuojë, nuk e ka kryer këtë detyrim përgjatë kohës që fëmija ka qenë i mitur. Kjo e drejtë të përfshijë kompensimin në përpjesëtim me pjesën që ka pasur mundësi për të kontribuar prindit cili nuk e ka plotësuar detyrimin.

BIBLIOGRAFIA

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
3. Kodi i Procedurës Civile
4. Ligji nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”,
5. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve
6. Konventa mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore
7. Konventa mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Detyrimet Ushqimore
8. Ligj nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Privat”
9. Ligji nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të garantuar nga Shteti”.
10. Vendimin nr 92/2013, Gjykata e Lartë
11. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH, Nr. 24, datë 21.4.2014, në ëë.gjk.gov.al
12. Vendimi nr. 136 datë 21.03.2017 Gjykata e Lartë
13. Janë përdorur statistikat e mbajtura nga
 - Gjykatat e Rretheve Gjyqësore në nivel kombëtar
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
 - Gjykata e Apelit Tiranë
 - Institucioni i Avokatit të Popullit